



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 613 Akti

Nr. 697 Vendimi
Tiranë, më 15.9.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Brunilda Bektashi	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 11.9.2023, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Adriatik Bocaj**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bektashi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Brunilda Bekteshi dhe Lulzim Hamitaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Brunilda Bekteshi.
4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Adriatik Bocaj, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
5. Subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar¹ mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
6. Në datën 26.7.2023, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 4.9.2023 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Në datën 23.8.2023, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 12 ditëve. Në datën 3.9.2023 subjekti dërgoi në rrugë elektronike dhe zyrtare shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.
8. Trupi gjykues, në datën 4.9.2023, me vendimin nr. 3, vendosi ta ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 6.9.2023, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 11.9.2023, në orën 14:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

¹Referojuni *email*-it të subjektit dhe deklarimit të tij (dokument *attach*), datë 12.1.2021.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 11.9.2023, për të rifilluar më 15.9.2023 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Z. Adriatik Bocaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit,

² Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

z. Adriatik Bocaj, me nr. *** prot., datë 10.7.2018, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ku më parë subjekti në datën 29.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2) datë 29.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Apartament me sip. 72.01 m², rruga “*”, blloku “***”, seksioni *** (***), shk. ***, k. ***, blerë sipas kontratës noteriale nr. ***, datë 24.8.2000.** Po në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se kjo pasuri ka rrjedhur nga:

*“Në vitin 1993 kam përfituar nga privatizimi i banesave në qytetin e Rrëshenit, ku kam blerë sipas kontratës nr. ***, datë 22.5.1993, apartament nr. ***, p. ***, shk. ***, k. ***, në vlerën 4.344 lekë.*

*Në vitin 1996, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 3.3.1996 i kam shitur Entit Kombëtar të Banesave Rrëshen apartamentin e përfituar, në vlerën 430.000 lekë.*

*Në vitin 1996, me anë të kontratës nr. ***, datë 4.4.1996 kam blerë një apartament banimi në Lezhë, në vlerën 600.000 lekë. Shumë kjo e ardhur nga kontrata e mësipërme nr. ***, datë 3.3.1996 plus shumën 170.000 lekë nga të ardhurat nga paga.*

Në vitin 2000, apartamentin e mësipërm e kam shitur sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 21.4.2000, në vlerën 2.000.000 lekë.

Në vitin 2000, me anë të kontratës së shitjes nr. *** kam blerë në Tiranë apartamentin që kam sot, me sipërfaqe 72.01 m², rruga “****”, blloku “****”, seksioni *** (***), shkalla ***, kati ***, në shumën 2.500.000 lekë. Kjo shumë përbëhet nga të ardhurat nga kontrata e mësipërme nr. ***, datë 21.4.2000 plus shuma 500.000 lekë nga të ardhurat nga paga. Vlera: 2.500.000 lekë. Zotërimi: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³”.

Hetimi i Komisionit

17.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 me përshkrimin “Shtëpi banimi, përfiturar në vitin 1990, sip. 72.01 m². Vlera: 2.500.000 lekë. Pjesa takuese: 25%. Burimi i krijimit: blerë nga shitja e shtëpisë në qytetin e Lezhës me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol.”.

17.2 Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se ZQRPP-ja⁴, me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2018, ka bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2018, të ZVRPP-së Tiranë, ku rezulton se z. Adriatik Bocaj ka të regjistruar pasuri me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji apartament me sip. 72.01 m², në rrugën “****”, Tiranë. Nga dokumentacioni i administruar në praktikë rezulton kartela e pasurisë, si dhe kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.8.2000, me palë shitëse Gj. dhe R.U dhe blerës Adriatik Bocaj, për apartamentin e ndodhur në Tiranë, rruga “****”, me sip. 72.01 m², në vlerën 2.500.000 lekë.

17.3 FSHU-ja⁵ informon se me gjeneralitetet Adriatik B. Bocaj identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. ***, në instancën Tiranë. Kontrata është hapur në datën 1.10.1997.

17.4 UKT-ja⁶ informon se në emër të z. Adriatik Bocaj rezulton kontrata nr. *** për objektin me adresë rruga “****”, Tiranë, me status “aktiv” në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara deri në janar 2021. UKT-ja për këtë kontratë ka vendosur në dispozicion dokument identifikimi, ID dhe vërtetim pronësie, të cilat përputhen me pasurinë objekt vlerësimi dhe gjeneralitetet e subjektit të rivlerësimit.

17.5 Komisioni konstatoi mospërputhje të deklaramit të subjektit, sa i takon pjesës takuese për këtë pasuri, pasi në DPV-në e vitit 2003 subjekti ka deklaruar 25%, ndërsa në deklaratën *Vetting* dhe në dokumentacionin e pronësisë subjekti ka deklaruar dhe zotëron 100%, si dhe në DPV-në e vitit 2003 nuk ka deklaruar edhe burimin tjetër – të ardhurat nga paga në shumën 500.000 lekë.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

17.6 Subjekti i rivlerësimit deklaron në deklaratën *Vetting* se burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në qytetin e Lezhës sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 21.4.2000, në vlerën 2.000.000 lekë; plus (ii) shuma prej 500.000 lekësh nga të ardhurat nga paga.

³ Vërtetim hipotekor datë 25.8.2000, në emër të z. Adriatik Bocaj, për apartament me sip. 72.01 m², Tiranë; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 24.8.2000, blerës Adriatik Bocaj, të apartamentit me sip. 72.01 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në vlerën 2.500.000 lekë; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 22.5.1993, blerës Adriatik Bocaj dhe shitës Ndërmarrja Komunale e Banesave, të apartamentit 1+1, ndodhur në Rrëshen, p. ***, në vlerën 4.344 lekë + kontratë privatizimi banese datë 9.4.1993 + praktika e kontratës; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 3.3.1996, shitës Adriatik Bocaj dhe blerës Enti Kombëtar i Banesave Rrëshen, të apartamentit 1+1, në p. ***, në vlerën 430.000 lekë; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.4.1996, blerës Adriatik Bocaj, për apartament, ndodhur në lagjen “****”, Lezhë, në vlerën 600.000 lekë; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.4.2000, shitës Adriatik Bocaj i apartamentit ndodhur në lagjen “****”, Lezhë, në vlerën 2.000.000 lekë. Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴ Aneks nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2021.

⁶ Me shkresën nr. ***1 prot., datë 30.3.2021.

17.6.1 Komisioni hetoi për secilin burim krijimi të përdorur për këtë pasuri.

i) Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në qytetin e Lezhës

17.6.2 Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se ZQRPP-ja⁷, me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2017, ka bashkëlidhur shkresën nr. ***, datë 13.10.2017, të ZVRPP Lezhë, ku rezulton se z. Adriatik Bocaj ka pasur të regjistruar pasuri me nr. ***, vol.***, f. ***, z. k. ***, lloji apartament me sip. 55.82 m², në Lezhë, përfitur me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.4.1996, blerës Adriatik Bocaj, në vlerën 600.000 lekë dhe shitur me kontratë shitjeje nr. ***, datë 21.4.2000, në vlerën 2.000.000 lekë. Bashkëlidhur shkresës janë kontratat e shitblerjes, certifikatë pronësie në emrin e blerësit T.N dhe kartelë pasurie.

17.6.3 Subjekti i rivlerësimit, në dokumentacionin e depozituar me pyetësorin nr. 1 për këtë pasuri, ka depozituar mandatarkëtimin nr. ***, viti 2000, ku identifikohet se subjekti ka paguar shumën 10.000 lekë për të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë. Sipas legjislacionit të kohës⁸, për çmim shitjeje deri në vlerën 2.000.000 lekë, tatimi i pagueshëm ka qenë në masën 0.5% të çmimit të shitjes.

17.6.4 Në analizë të kontratës së shitjes, e cila për nga forma, por edhe nga pasojat e prodhuara rezulton konform legjislacionit civil, pasi ka parashikuar palët kontraktore, objektin, ka përcaktuar vlerën e shitjes së pasurisë, është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve, duke u regjistruar në hipotekë në favor të blerësit.

17.6.5 Për sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika për këto të ardhura, pasi kontrata është e rregullt me të gjitha elementet e saj, si dhe është paguar detyrimi tatimor për të ardhurat e përfituara.

ii) Në lidhje me të ardhurat nga paga në shumën 500.000 lekë

17.6.6 Komisionit, gjatë hetimit, i ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka qenë e punësuar për periudhën 1.1.1994 – 31.5.1994 pranë Këshillit të Rrethit Mirditë⁹ dhe për periudhën 1.3.1998 – 30.6.2000 pranë shoqërisë “***”, Lezhë¹⁰, ndërsa subjekti i rivlerësimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për periudhën 1.7.1994 – dhjetor 2013. Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit në dokumentacionin e administruar janë bruto dhe Komisioni i ka përllogaritur ato sipas legjislacionit¹¹ të kohës dhe ka përfshirë në analizë shumën neto.

17.6.7 Komisioni kreu analizën financiare për periudhën nga data 4.4.1996 kur është blerë pasuria apartament në qytetin e Lezhës në shumën 600.000 lekë dhe që më pas u shit, të ardhura të cilat shërbyen si burim krijimi për blerjen e pasurisë në qytetin e Tiranës, në datën 24.8.2000, objekt i këtij hetimi administrativ.

17.6.8 Në analizën financiare të kryer, Komisioni pasqyroi të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar për periudhën e analizuar dhe specifikisht:

- të ardhurat nga punësimi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes;
- të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në qytetin e Lezhës, datë 21.4.2000, në vlerën 2.000.000 lekë;

⁷ Aneks nr. 27 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

⁹ Sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme, aneks nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰ Sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme, aneks nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹¹ VKM Nr. 610, datë 31.12.1993, VKM Nr. 42, datë 23.1.1995, VKM Nr. 20, datë 13.1.1997, VKM Nr. 73, datë 30.1.1998, VKM Nr. 112, datë 18.3.1999, ligji nr. 7786, datë 27.1.1994, ligji nr. 7897, datë 2.2.1995, ligji nr. 8091, datë 21.3.1996, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

- shpenzimet e jetesës janë marrë në masën 66% e të ardhurave për periudhën 1996 – 1999 dhe sipas INSTAT-it për vitin 2000;
- shpenzime mobilimi për apartamentin në qytetin e Lezhës sipas deklaratimit të subjektit;
- shpenzime për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në qytetin e Lezhës;
- blerja e apartamentit në qytetin e Tiranës në vlerën 2.500.000 lekë, në datën 24.8.2000.

17.6.9 Komisioni, nga përlllogaritjet financiare të kryera, konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit rezultoi me një balancë negative në shumën 49.903 lekë për të investuar në këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

17.6.10 Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksionit të tij dhe shitësve të pasurisë, Gj. dhe R.U.

Subjekti depozitoi përgjigjet e institucioneve punëdhënëse¹², të cilat konfirmojnë se ai nuk ka gjykuar çështje gjyqësore, ku palë ndërgjyqëse ose si kërkues të kenë qenë shitësit e pasurisë.

17.6.11 Komisioni, në kuadër të verifikimit të ndonjë trajtimi të mundshëm preferencial me pyetësorin nr. 3, datë 26.6.2023, i ka kërkuar subjektit të depozitohet kontrata të ngjashme. Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.6.2000, për apartamentin nr. ***, p. ***, shk. ***, k. ***, që ndodhet në të njëjtin pallat me pasurinë e subjektit. Nga verifikimi i kontratës rezultoi se çmimi i shitjes për këtë apartament me sip. 89 m² është 2.000.000 lekë.

17.6.12 Komisioni, bazuar në faktet e tilla: (i) kontrata e blerjes së pasurisë objekt hetimi mes subjektit të rivlerësimit dhe shitësve është nënshkruar mes dy individëve me vullnetin e tyre të lirë; (ii) koha e përfitimit të kësaj pasurie daton në vitin 2000; (iii) referuar kontratës së ngjashme të depozituar nga subjekti, të dhënat pasqyrojnë blerjen e një apartamenti në të njëjtin pallat, në të njëjtin vit; (iv) rezultoi se subjekti e ka blerë apartamentin me një sipërfaqe më të vogël, por me një çmim më të lartë sesa sipërfaqja dhe çmimi i referuar në kontratën e ngjashme që subjekti depozitoi – konstato se duket se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e ndonjë trajtimi të mundshëm preferencial.

17.6.13 Gjithashtu, Komisioni kreu edhe analizën financiare për të parë mundësitë e subjektit për të investuar në blerjen e apartamentit në qytetin e Lezhës, pavarësisht se pasuria apartament në Lezhë është shitur, pra nuk disponohet më nga subjekti.

17.6.14 Në analizën financiare të kryer, Komisioni pasqyrojti të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar për periudhën e analizuar dhe specifikisht:

- të ardhurat nga punësimi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes;
- të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në qytetin e Rrëshenit datë 8.3.1996, në vlerën 430.000 lekë¹³;
- shpenzimet e jetesës, të cilat janë marrë në masën 66% të të ardhurave;
- blerja e apartamentit në qytetin e Lezhës në vlerën 600.000 lekë më 4.4.1996.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2023, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe shkresë nr. *** prot., datë 21.6.2023, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

¹³ Blerës i këtij apartamenti është EKB-ja. Veprim i lejuar sipas shkronjës “g” të VKM-së Nr. 198, datë 4.5.1993, për krijimin e EKB-së. Subjekti nuk ka pasur detyrim për të paguar tatim për të ardhurat e përfituara nga kjo shitje sipas ligjit nr. 7786, datë 27.1.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”.

17.6.15 Komisioni, nga përlogaritjet financiare të kryera, konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit rezultoi me një balancë negative në shumën 51.954 lekë për të investuar në këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

17.6.16 Njëkohësisht Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksionit të tij dhe shitësve të pasurisë S. dhe L.A. Subjekti depozitoi përgjigjet e institucioneve punëdhënëse¹⁴, të cilat konfirmojnë se ai nuk ka gjykuar çështje gjyqësore ku palë ndërgjyqëse ose si kërkues të kenë qenë shitësit e pasurisë. Bazuar në dokumentacion e administruar, Komisioni konstatoi se duket se subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

17.6.17 Në përfundim për këtë pasuri, Komisioni, në analizë të fakteve e rrethanave të dala përgjatë hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës, pasi ka konstatuar se: (i) subjekti ka mospërputhje të deklaramit të tij, sa i takon pjesës takuese për këtë pasuri, pasi në DPV-në e vitit 2003 ka deklaruar 25%, ndërsa në deklaratën *Vetting* dhe dokumentacionin e pronësisë subjekti ka deklaruar se zotëron 100%, si dhe në DPV-në e vitit 2003 nuk ka deklaruar edhe burimin tjetër, të ardhurat nga paga në shumën 500.000 lekë; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 49.903 lekë për të investuar pasurinë “apartament me sip. 72.01 m², rruga “****”/Tiranë”, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare; (iii) subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 51.954 lekë për të investuar në pasurinë në qytetin e Lezhës, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

17.7 Në prapësimet e tij në funksion të barrës së provës, subjekti ka parashtruar se pasuria apartament me sip. 72.01 m², rruga “****”, është blerë sipas kontratës noteriale nr. ***, datë 24.8.2000, ku në deklaratën *Vetting* ka deklaruar detajisht dhe me saktësi përfitimin e kësaj pasurie.

17.7.1 Këtë pasuri, po ashtu, e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 me përshkrimin “Shtëpi banimi, përfituar në vitin 1990, sip. 72.01 m². Vlera: 2.500.000 lekë. Pjesa takuese: 25%. Burimi i krijimit: blerë nga shitja e shtëpisë në qytetin e Lezhës me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr.*** kol.”.

17.7.2 Lidhur me mospërputhjen e deklaramit të tij, sa i takon pjesës takuese për këtë pasuri dhe burimin tjetër të krijimit të ardhurat nga paga, subjekti ka pranuar faktin se burimi i krijimit të kësaj pasurie nuk është deklaruar i plotë në DPV-në periodike, duke shpjeguar se ai duke pasur parasysh që vlera e shitjes së apartamentit në qytetin e Lezhës ishte 2.000.000 lekë dhe vlera e blerjes së apartamentit në qytetin e Tiranës 2.500.000 lekë, si dhe duke vlerësuar në atë kohë (deklarimi i parë i pasurisë) se i vetmi burim tjetër i familjes së tij për krijimin e kësaj pasurie ishin të ardhurat nga paga, nuk i ka deklaruar këto të ardhura (pra ato nga paga) si burim të diferencës 500.000 lekë. Gjithashtu, ka shpjeguar se ai në DPV-në periodike ka deklaruar se zotëron ¼ të kësaj pasurie nisur nga fakti se burimi kryesor i blerjes së këtij apartamenti vinte si pasojë e privatizimit të apartamentit në qytetin e Rrëshenit dhe në momentin e deklaramit familja e tij përbëhej nga 4 persona. Sipas subjektit, këto pasaktësi të karakterit formal në DPV-në vjetore të vitit 2003 (në deklaratën e parë të pasurisë) i ka ndrequr në deklaratën *Vetting*, duke deklaruar saktësisht mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, si dhe burimin e krijimit të saj.

17.7.3 Në vijim, subjekti ka parashtruar kundërshti lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke ngritur pretendime në lidhje me: (i) përlogaritjen e shpenzimeve jetike, të cilat nuk duhet të jenë në masën 66% të të ardhurave, por sipas tij ato duhet të përlogariten në masën

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2023, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe shkresë nr. *** prot., datë 21.6.2023, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

30% të të ardhurave, referuar Jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit (vendimi nr. 15/2021). Në këtë drejtim subjekti ka parashtruar se ai përpara vitit 1994 ka punuar inxhinier në minierë dhe të ardhurat nga punësimi në minierë kanë qenë më të lartat në vend dhe kjo është dhe një arsye më shumë që shpenzimet jetike të familjes së tij në këtë periudhë duhet të përlogariten në masën 30% të të ardhurave; (ii) përlogaritjen e të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e tij pranë Këshillit të Rrethit Mirditë, duke depozituar vërtetimin përkatës.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

17.8 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, arsyeton si vijon:

17.8.1 Lidhur me mospërputhjen e deklaramit të tij, sa i takon pjesës takuese për këtë pasuri dhe burimit tjetër të krijimit të *ardhurat nga paga*, trupi gjykues, duke konstatuar se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë zotërimin e pjesës takuese sipas dokumentacionit ligjor të përfitimit të kësaj pasurie, konfirmuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, vlerëson se subjekti ka kryer deklaramit të pasaktë në DPV-në e vitit 2003 lidhur me pjesën takuese të pasurisë dhe mospërcaktimin e burimit tjetër të ardhurat nga paga. Trupi gjykues, referuar jurisprudencës së Kolegjit¹⁵, çmon se kjo pasaktësi në deklaramin periodik, e pashoqëruar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, sikurse do të arsyetohet në vijim – nuk përbën shkak për aplikimin e nenit 61, pika 3 e këtij ligji, pasi nuk ndodhemi në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe, si e tillë, vlerësohet pa pasojë në procesin e rivlerësimit të tij.

17.8.2 Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë të të ardhurave të siguruara nga bashkëshortja e tij, trupi gjykues çmon se bazuar në dokumentin “Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga Drejtoria e Statistikës Mirditë”, provohet fakti që bashkëshortja e tij ka përfituar të ardhurat nga punësimi, për periudhën maj 1994 – korrik 1995 dhe dhjetor 1995. Trupi gjykues vlerëson se ato duhet të merren në konsideratë pasi plotësojnë kriteret e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Meqenëse dokumentacioni i depozituar nga subjekti në prapësime pasqyron të ardhurat bruto, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu përlogaritjet sipas legjislacionit të kohës, nga ku rezultoi se vlera neto e përfituar për periudhën maj 1994 – korrik 1995 dhe dhjetor 1995 është 93.323 lekë.

17.8.3 Lidhur me pretendimin e subjektit për përlogaritjen e shpenzimeve në masën 30%, trupi gjykues mori në analizë rrethanat faktike të subjektit në raport me vendimin nr. 15/2021 (pg 21.40-21.42¹⁶) të Kolegjit, i cili në funksion të një qëndrimi orientues, sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka arsyetuar mbi këtë çështje.

17.8.4 Në këtë drejtim, trupi gjykues, referuar arsyetimit të Kolegjit në vendimin e sipërcituar ku në rastin e analizës financiare kur figurojnë të ardhura të siguruara nga puna e gjyqtarëve apo prokurorëve shpenzimet e jetesës duhet të llogariten në masën 30% të të ardhurave, i cili përafron me masën e shpenzimeve për jetesë në raportin 66% të të ardhurave që i përkasin pagave mesatare

¹⁵ Vendimi nr. 31/2021, datë 12.10.2021.

¹⁶ Pg. 21.40 i vendimit nr. 15/2021 të Kolegjit: “Në lidhje me kërkimin e Komisionerit Publik në ankim, për nevojën e një qëndrimi orientues të Kolegjit për metodologjinë që duhet përdorur për sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të jetesës për periudhën për të cilën nuk gjejmë gjurmë në anketat apo publikimet e INSTAT-it, Kolegji vlerësoi këtë kërkim në raport me informacionin që përmban raporti i Bankës së Shqipërisë i vitit 1995, sipas të cilit shtetasit shqiptarë shpenzojnë për jetesë rreth 66% të të ardhurave të tyre nga punësimi në sektorin publik, të cilat përlogariten mesatarisht në vlerën prej 800 USD në vit. Në funksion të një qëndrimi orientues, sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji parashtron arsyetimin në vijim...”.

të të gjithë sistemit të pagave, vlerëson ta marrë në konsideratë pretendimin e subjektit të rivlerësimit. Ky vlerësim konsiderohet edhe nga fakti se të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit janë mbi mesataren e sektorit publik, pasi ai ka përfituar mbi 800 USD/vit për periudhën e analizuar.

17.8.5 Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se në rastin e subjektit Adriatik Bocaj, ku përbërja familjare është prej 4 (katër) anëtarësh, ka rrethana që, përmes një analize të logjikshme dhe objektive, zëri i shpenzimeve jetike të pranohet në masën 30%.

17.8.6 Në përfundim, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu ripërlllogaritjet duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit të arsyetuara më sipër në këtë vendimmarrje lidhur me: (i) të ardhurat nga punësimi të bashkëshortes për periudhën maj 1994 – dhjetor 1995; (ii) përlllogaritjen e shpenzimeve jetike në masën 30%, të cilat janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Përshkrimi	1.1.1994 – 4.4.1996	4.4.1996 – 24.8.2000
1	TË ARDHURA	870,516	3,602,896
	Të ardhura nga paga subjekti	324,227	1,468,812
	Të ardhura nga paga bashkëshortja	116,289	134,083
	Të ardhura nga shitja e apartamentit Lezhë		2,000,000
	Të ardhura nga shitja e apartamentit Rrëshen	430,000	
2	SHPENZIME	132,155	697,890
	Shpenzime jetese 30% e të ardhurave deri më 1999	132,155	379,090
	Shpenzime jetese sipas INSTAT-it për vitin 2000		288,000
	Shpenzime mobilimi ap. Lezhë		20,800
	Pagesë tatim në burim		10,000
3	PASURI	600,000	2,500,000
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme		
	Apartament me sip. 72.01 m ² në Tiranë		2,500,000
	Apartament me sip. 55.82 m ² në Lezhë	600,000	
	DIFERENCA (1-2-3)	138,361	405,005

17.8.7 Nga analiza financiare e kryer pas prapësimeve të subjektit dhe vlerësimeve të trupit gjykues rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për të investuar në pasurinë apartament banimi me sip. 72.01 m², në rrugën “*****/Tiranë në vitin 2000, të investojë në blerjen e pasurisë apartament në qytetin e Lezhës në vitin 1996, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

18. Automjet tip “Skoda Yeti 2.0 TDI 4x4”, me targë *.** Burimi i krijimit: blerë me anë të kontratës së qirasë financiare nr. ***, datë 30.1.2012, si dhe kontratës së shitjes nr. ***, datë 9.1.2017, si dhe huaja në shumën 6.000 euro, sipas kontratës së huas nr. ***, datë 23.1.2012. Vlera: 22.980 euro. Zotërimi: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹⁷.

¹⁷ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 9.1.2017, blerës Adriatik Bocaj, i automjetit tip “Skoda Yeti”, me targë *** dhe shitës shoqëria “****” sh.a. + certifikatë pronësie e automjetit me targë ***, në emër të shoqërisë “****” sh.a.; certifikatë pronësie e automjetit me targë ***, në emër të z. Adriatik Bocaj; kontratë qiraje financiare nr. ***, datë 30.1.2012, midis shoqërisë “****” sh. a. (qiradhënës) dhe z. Adriatik Bocaj (qiramarrës), për automjetin tip “Skoda Yeti”, në vlerën 19.300 euro + praktika e plotë e kontratës financiare; kontratë hua (pa interes) nr. ***, datë 23.1.2012 midis huadhënësit M.G dhe huamarrësit Adriatik Bocaj, të shumës 7.000 euro, deri në datën 20.12.2017, pa interes + kartë ID. Aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

18.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj shprehet: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR-së (sipas kontratës së qirasë financiare vlera e automjetit është 19.300 euro, nga e cila parapagim 6.000 euro, shuma e financuar me kredi 13.300 euro, komisioni 199.5 euro. Vlera 22.980 euro është llogaritur së bashku me pagesën e kësteve të shlyera për qiranë financiare).

Hetimi i Komisionit

18.2 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011. Në këtë deklaratë ai ka deklaruar: (i) huan e marrë në shumën 7.000 euro sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., me datë fillimi 23.1.2012 dhe datë mbarimi 20.12.2017 për parapagimin e 31.1% të blerjes së automjetit; (ii) kredinë bankare për blerje automjeti në shumën 17.015,4 euro, kohëzgjatja nga 16.2.2012 deri më 16.1.2017 me këst mujor 282.59 euro. Duket se në këtë deklaram subjekti ka deklaruar shumën totale që duhet të paguante lidhur me kredinë, pra principal + interes.

18.3 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 subjekti ka deklaruar kredinë në shumën 13.300 euro, të marrë nga shoqëria “***” me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2012, si dhe huan në shumën 7.000 euro, marrë sipas kontratës nga huadhënësi M.G.

18.4 Shoqëria “Landeslease”¹⁸ informon se ka pasur marrëdhënie me qiramarrësin Adriatik Bocaj, e cila ka filluar më 30.1.2012 dhe ka përfunduar në datën 9.1.2017. Ky institucion financiar ka depozituar të gjithë dosjen e kësaj marrëdhënieje, finalizuar me kontratën e qirasë financiare nr. *** , nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2012, e nënshkruar mes palës qiradhënëse “***” sh.a. dhe palë qiramarrëse Adriatik Bocaj, planin e pagesave nga data 16.2.2012 deri më 16.1.2017, si dhe kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.1.2017.

18.5 DPSHTRR-ja¹⁹ informon se z. Adriatik B. Bocaj ka të regjistruar automjetin me targë ***. Kjo drejtori ka vendosur në dispozicion dosjen e plotë të mjetit, nga ku rezulton se është blerë me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.1.2017, me palë shitëse “***” sh.a. dhe palë blerëse Adriatik Bocaj.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

18.6 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim krijimi për këtë pasuri është kontrata e qirasë financiare e marrë pranë shoqërisë “***” sh.a. dhe 6.000 euro të përdorura nga huaja e marrë nga shtetasi M.G në shumën 7.000 euro.

i) Lidhur me kontratën e qirasë financiare

18.6.1 Komisioni ka administruar kontratë qiraje financiare nr. *** , nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2012, për blerjen e automjetit tip “Skoda Yeti”, ku përcaktohet se çmimi i blerjes në shumën 19.300 euro, nga të cilat parapagim 31.1% e çmimit të blerjes, 6.000 euro dhe shuma e financimit 68.9%, 13.300 euro. Afati i qirasë financiare 60 muaj (5 vjet).

18.6.2 Komisioni duket se nuk ngre dyshime për këtë burim krijimi, pasi shuma është përcaktuar dhe siguruar sipas një kontrate qiraje financiare. Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka paguar çdo muaj këstin përkatës dhe e ka mbyllur këtë detyrim sikurse ishte parashikuar në kontratë në datën 9.1.2017. Pas shlyerjes totale është nënshkruar kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.1.2017 për automjetin tip “Skoda Yeti”.

¹⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2021.

¹⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2021.

ii) Lidhur me huan e marrë nga shtetasi M.G

18.6.3 Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë huamarrje në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 dhe 2012. Gjithashtu ai ka deklaruar në çdo deklaratë të mëvonshme/vijuese detyrimin e mbetur.

18.6.4 Për këtë hua subjekti ka nënshkruar kontratën e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2012 me palë huadhënëse M.G dhe palë huamarrëse Adriatik Bocaj. Në këtë kontratë huadhënësi deklaroi se jashtë zyrës noteriale i ka dorëzuar huamarrësit, sot në datën 23.1.2012 shumën e parave prej 7.000 euro, se kjo shumë parash është pronë e tij, të cilën e ka përfituar nga aktiviteti i tij privat. Huamarrësi deklaroi se këtë shumë e merr për blerjen e një automjeti. Palët në këtë kontratë kanë rënë dakord që kjo shumë të kthehet deri më 20.12.2017.

18.6.5 Komisioni e ka pyetur²⁰ subjektin lidhur me burimin e krijimit të shumës 7.000 euro nga huadhënësi, marrëdhënien që ka pasur me shtetasin G., si dhe i ka kërkuar të depozitonte dokumentacion justifikues. Subjekti në përgjigje ka shpjeguar se “... shtetasi M.G është djali i kushëririt tim të parë, me të cilin për shkak edhe të banimit të tij në Tiranë kam marrëdhënie të afërta familjare. Bazuar në këtë marrëdhënie këtij shtetasi i kam marrë hua shumën 7.000 euro në vitin 2012, hua të cilën e kam deklaruar edhe nga DPV-të vjetore. Në dijeninë time, nipi im kishte të ardhura të mira të siguruara nga puna e tij e vërtetuar nga librezat e punës. Për të kthyer përgjigje pyetjes së drejtuar nga Komisioni i kam kërkuar z. G. të më vendosë në dispozicion dokumentacionin për burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij. Ky shtetas më ka shpjeguar se babai i tij, shtetasi H.G, është ish i përndjekur politik dhe ka përfituar dëmshpërblim në bazë të legjislacionit në fuqi. Ka qenë dëshira e babait të tij që dëmshpërblimin e marrë si ish i përndjekur politik t’ua shpërndante fëmijëve. Këstin e vitit 2010, në shumën 1.000.000 ai i ka dhënë cash djalit të tij M.G. Kjo shumë është burim i ligjshëm i shumës 7.000 euro, të cilën ma ka dhënë hua. Shuma 1.000.000 lekë ka kaluar në llogarinë bankare të z. H.G, sipas urdhër pagesës me nr. *** prot., në datën 27.5.2010, të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë”.

18.6.6 Në mbështetje të këtij deklarimi subjekti ka depozituar: deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.6.2023, të shtetasit H.G, ku nga verifikimi përkatës Komisioni vëren se konfirmohet dhënia e shumës 1.000.000 lekë djalit të tij M.G; statement bankar i llogarisë së H.G, ku nga verifikimi përkatës Komisioni vëren se pasqyrohet kreditimi i shumës 1.000.000 lekë në datën 1.6.2010 nga Ministria e Financave, si dhe tërheqja e kësaj shume në datat 22.7.2010 dhe 24.9.2010; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.6.2023 e shtetasit M.G, ku nga verifikimi përkatës Komisioni vëren se konfirmohet marrja e shumës 1.000.000 lekë; librezë pune të shtetasit M.G, ku nga verifikimi përkatës Komisioni vëren se për periudhën 7.1.1998 – 23.3.2006 ai ka qenë i punësuar pranë zyrës së *** Gjirokastër.

18.6.7 Komisioni, nisur nga kontrata e huas e vitit 2012, në të cilën huadhënësi deklaronte se të ardhurat i kishte përfituar nga aktiviteti i tij privat, por edhe nga deklarimi i subjektit në pyetësorin standard dhe nga dokumentacioni i depozituar, kontratë qiraje për ambient me qira e vitit 2010 mes qiradhënësit H.R dhe qiramarrësit M.G, hetoi për burimin e ligjshëm të të ardhurave.

18.6.8 Nga hetimi për shtetasin G. rezultoi se: QKB-ja²¹ informon se shtetasi M.H.G rezultoi i regjistruar si person fizik me NIPT ***. Nga ekstrakti rezultoi se aktiviteti është regjistruar në datën 21.8.2015. DRT Tiranë²² informon se shtetasi M.H.G rezultoi i regjistruar si person fizik

²⁰ Pyetësor nr. 2, datë 19.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

²¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2023.

²² Me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2023.

me NIPT ***, i regjistruar në sistemin tatimor më 21.8.2015. Aktiviteti “****” me status ligjor person fizik.

18.6.9 Nga dokumentacioni i lartpërmendur, Komisioni konstaton se duket se: (i) shtetasi G. mund ta ketë ushtruar aktivitetin e tij *** që prej vitit 2010, por i paregjistruar sipas legjislacionit tatimor; (ii) gjatë hetimit, subjekti ka depozituar librezën e punës së shtetasit G., por në të pasqyrohet punësimi deri në muajin mars 2006 dhe më tej nuk ka të dhëna për të ardhura të përfituara; (iii) subjekti ka depozituar deklaratën noteriale për përfitimin e shumës 1.000.000 lekë nga z. G. nga babai i tij, por duket se deklarimi përkatës në raport me marrjen e shumës *cash* mbetet në nivel deklarativ; (iv) nga hetimi rezultoi që shtetasi M.G deri në momentin e dhënies së huas ka investuar në blerjen e një automjeti²³ në datën 30.7.2011, në vlerën 530 euro.

18.6.10 Për faktet e sipërcituara, deri në fazën e hetimit, Komisioni konstatoi se duket se nuk provohej bindshëm burimi i ligjshëm i krijimit të shumës 7.000 euro.

18.6.11 Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2012, kur është investuar në blerjen e kësaj pasurie, duke mos marrë në konsideratë deri në këtë fazë të hetimit të ardhurat nga huamarrja.

18.6.12 Në përfundim për këtë pasuri, sipas hetimit të sipërcituar, Komisioni, në analizë të fakteve e rrethanave të dala përgjatë hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës pasi ka konstatuar se dukej se: (i) nuk përputhej deklarimi i subjektit për burimin e krijimit të shumës së marrë hua, pasi në deklaratën e huas së vitit 2012, huadhënësi ka deklaruar si burim të ardhura nga aktiviteti i tij privat, ndërsa gjatë hetimit ka deklaruar shumën e përfituar nga babai i tij si ish i dënuar politik dhe, për rrjedhojë, nuk provohej bindshëm burimi i krijimit të huas për shkak të deklarimeve kontradiktore; (ii) subjekti nuk ka pasur mundësi në shumën 815.443 lekë në vitin 2012, për blerjen e automjetit, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18.7 Në prapësimet e tij, në funksion të barrës së provës, subjekti ka parashtuar se huan e marrë nga shtetasi M.G e ka dokumentuar rregullisht sipas kontratës së huas të lidhur në momentin e marrjes së saj. Subjekti ka shpjeguar se ai ka deklaruar në vazhdimësi burimin e krijimit, sikurse i është deklaruar nga huadhënësi, si dhe ka paraqitur kontratën e huas në kohë reale (bashkëlidhur DPV-së së vitit 2011), por edhe bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dhe po ashtu edhe në pyetësonin nr. 01, siç është deklaruar nga huadhënësi në kontratë.

18.8 Subjekti ka prapësuar se bazuar në legjislacionin e vitit 2012 subjektet deklaruese nuk kanë pasur detyrimin të provojnë burimin e ligjshëm të shumave të marra hua nga personat huadhënës.

18.9 Subjekti ka deklaruar se ai ka vënë në dispozicion për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit dokumentacionin që i është vënë në dispozicion nga huadhënësi. Në këtë drejtim ai ka kërkuar të konsiderohet burimi i krijimit për shkak se Komisioni ka konkluduar se shuma 1.000.000 lekë është marrë nga i ati i huadhënësit si ish i dënuar politik, se është provuar edhe transferta bankare nga Ministria e Financave dhe gjithashtu është provuar edhe tërheqja e shumës.

18.10 Subjekti ka prapësuar se duhet konsideruar qëndrimi i konsoliduar i Kolegjit prej vendimit nr. 15/2019, nr. 2/2023 e, në vijim, se analiza financiare dhe kontrolli që i bëhet deklarimeve të personave të tjerë të lidhur nuk mund të jetë i të njëjtit standard të përdorur për subjektin rivlerësues.

18.11 Sipas subjektit, fakti që shtetasi M.G mund të ketë pasur edhe burime të tjera të ardhurash për të cilat ai mund të mos vërtetojë pagesën e detyrimeve tatimore, nuk mund kursesi të zerojë

²³ Sipas shkresës së përcjellë nga DPSHTRR-ja nr. *** prot., datë 19.6.2023.

burimet e tjera të të ardhurave të tij, që kanë shërbyer për shumën për të cilën i ka dhënë hua. Subjekti ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat e shtetasit M.G në periudhën 1998 – 2006. Sipas subjektit, në rastin konkret ai nuk mund të penalizohet për një deklaram jo të plotë apo të pasaktë të një personi tjetër, qoftë ky edhe person tjetër i lidhur. Subjekti prapëson se ka provuar ekzistencën e marrëdhënies së huas me kontratë të rregullt noteriale të kohës, hua e deklaruar rregullisht në të gjitha DPV-të vjetore.

18.12 Gjithashtu, ai ka prapësuar se sipas jurisprudencës së Kolegjit (por edhe të Komisionit) mjafton që huadhënësi, si person tjetër i lidhur, të provojë se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje nga çdo burim i ligjshëm, në mënyrë që kjo shumë të konsiderohet e ligjshme dhe të përfshihet në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit. Sipas tij, edhe në jurisprudencën e organeve të rivlerësimit, analiza dhe deklaramet e personave të tjerë të lidhur nuk mund të vlerësohen me të njëjtën ashpërsi dhe standard që vlerësohen deklaramet e subjekteve të rivlerësimit.

18.13 Subjekti kërkon të vlerësohen deklaramet noteriale të shtetasit H.G dhe djalit të tij M.G, si dhe dokumentacioni bankar i përfitimit të shumës 1.000.000 lekë të një kësti dëmshpërblimi nga shtetasi H.G, shumë e cila është më se e mjaftueshme për të mbuluar huan. Ai ka deklaruar se huadhënësi M.G nuk ka qenë subjekt deklarues dhe për këtë arsye nuk ka pasur detyrimin të dokumentojë të ardhurat e përfituara nga babai i tij. Gjithashtu, ai ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat e shtetasit M.G në periudhën 1998 – 2006.

18.14 Në përfundim, subjekti ka kërkuar që të konsiderohet në analizën financiare shuma 1.000.000 lekë, si burim krijimi i huas, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e Kolegjit, duke paraqitur në mënyrë tabelare ripërlllogaritjet e analizës financiare, pas së cilës rezulton në balancë pozitive.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

18.15 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, arsyeton si vijon:

18.16 Në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni e ka konsideruar huadhënësin M.G si person tjetër të lidhur dhe, në këtë kuptim, subjekti ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të marra hua prej huadhënësit. Ligji nr. 84/2016 dhe ligji nr. 9049/2003 kërkojnë që subjektet deklaruese të identifikojnë personat e tjerë të lidhur me të cilët subjektet janë në marrëdhënie interesash apo detyrimesh, me qëllim ekspozimin e këtyre personave që ligjet i përkufizojnë si “persona të tjerë të lidhur” ndaj kontrollit të organeve verifikuese në drejtim të pasurisë e të konfliktit të interesit. Në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, Komisioni ka identifikuar faktet se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë marrëdhënie huaje në deklaramet periodike dhe në atë *Vetting*, duke identifikuar gjithashtu huadhënësin, shtetasin M.G. Po ashtu, nga hetimi rezultoi e provuar se kjo marrëdhënie konfirmohet me akt noterial të kohës, kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., me datë fillimi 23.1.2012 dhe datë mbarimi 20.12.2017 për parapagimin e 31.1% të blerjes së automjetit.

18.17 Në referim të të dhënave faktiko-ligjore të sipërcituara, trupi gjykues, përgjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se ka të dhëna kontradiktore sa i takon deklaramet të huadhënësit për burimin e ligjshëm të shumës së dhëna hua, pasi në deklaramet e huas së vitit 2012, huadhënësi ka deklaruar si burim të ardhura nga aktiviteti i tij privat, ndërsa gjatë hetimit ka deklaruar shumën e përfituar nga babai i tij si ish i dënuar politik. Në analizë të provave të administruara, trupi gjykues konstaton se kjo e ardhur vjen nga një burim i ligjshëm, porse për shkak të disa fakteve të tjera

konstatuese se: (i) huadhënësi ka ndryshuar deklarin e burimit; (ii) subjekti ka depozituar deklaratën noteriale për përfitimin e shumës 1.000.000 lekë nga z. G. nga babai i tij, por deklarimi përkatës gjatë procesit të rivlerësimit në raport me marrjen e shumës *cash* vlerësohen pa relevancë, pasi ato mbeten në nivel deklarativ, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të huas dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur mundësi në shumën 806.699 lekë në vitin 2012 për blerjen e automjetit, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

18.18 Trupi gjykues, për shkaqet e arsytuara më sipër, ka çmuar të mos e konsiderojë huan në shumën 7.000 euro, duke vlerësuar gjithashtu se referimi i subjektit në vendimet e Kolegjit nr. 15/2019²⁴ dhe nr. 2/2023²⁵ është i gabuar, pasi këto vendime lidhen me arsyetimin e çështjes së burimeve të krijimit të pasurive, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur.

18.19 Në përfundim, trupi gjykues balancën negative prej 806.699 lekësh në vitin 2012 për blerjen e automjetit, si pasojë e deklarimeve kontradiktore që lidhen me statusin e personave të tjerë të lidhur, çka nuk përjashton detyrimisht hipotezën e pasjes së burimeve të tjera, e vlerëson në raport me peshën që ato marrin lidhur me vlerësimin përfundimtar për këtë subjekt.

19. Gjendje në llogarinë rrjedhëse në Bankën Kombëtare Tregtare, krijuar nga kursimet e pagës. Vlera: 218.320 lekë. Zotërimi: 100%. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar: nxjerrje llogarie datë 17.1.2017 nga BKT-ja në emër të z. Adriatik Bocaj, me gjendje në datën 16.1.2017, në vlerën 218.320 lekë.

19.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT-së.

19.2 Nga korrespondenca e Komisionit me Bankën Kombëtare Tregtare²⁶ konfirmohet llogari rrjedhëse me gjendje 218.320,08 lekë në datën 23.1.2017 në emër të subjektit. Në këtë llogari subjektit të rivlerësimit i kreditohet paga.

19.3 Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

DETYRIME FINANCIARE

20. Hua e marrë në shumën 7.000 euro, me kontratën nr. *, me datë fillimi 23.1.2012 dhe datë mbarimi 20.12.2017 për parapagimin e 31.1% të vlerës së blerjes së automjetit. Shuma e detyrimit 7.000 euro.** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës deklaraten noteriale nr. ***, datë 18.1.2017, me deklarues M.G, i cili deklaron se ka një kontratë huaje të datës 23.1.2012, në të cilën

²⁴ Pika 110 e vendimit nr. 15/2019 të Kolegjit arsyeton se : “*Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive”.*

²⁵ Pika 18.7 e vendimit nr. 2/2023 të Kolegjit arsyeton se: “*Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik, se në analizën e Komisionit nuk janë përfshirë investimet e bëra nga huadhënësi A. LL., të cilat nëse gjejnë aplikim, analiza e personit tjetër të lidhur rezulton me situatë ekonomike negative, në vijim të qëndrimit të mbajtur më sipër, për sa i përket të njëjtit pretendim të ngritur edhe në drejtim të analizës së babait të subjektit të rivlerësimit K. S., si person tjetër i lidhur, Kolegji çmon se: “Në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, edhe në këtë rast, si dhe në referim të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, lidhur me interpretimin e kësaj dispozite, nuk do të konsiderohet si shpenzim, me të cilin duhej ngarkuar analiza financiare e personit tjetër të lidhur A. LL.” – ku referohet sërish vendimi nr. 15/2019.*

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 23.3.2021.

ka dhënë hua shumën 7.000 euro, të cilën e ka përfituar nga aktiviteti i tij “bar-kafe”, bashkëlidhur deklaratës kontratë huaje nr. ***, datë 23.1.2012 dhe kartë ID.

20.1 ILDKPKI-ja, në raportin e tij, është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar (në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2017, subjekti ka deklaruar se ka kryer shlyerje të huas në shumën 5.000 euro, detyrimi i mbetur 2.000 euro).*

20.2 Komisioni huan e marrë në vitin 2012 me qëllim për blerje automjeti e ka trajtuar në pasurinë nr. 2. Deri në momentin e depozitimit të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk e kishte shlyer këtë hua dhe detyrimi i mbetur ishte 7.000 euro.

20.3 Nga hetimi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shlyer 5.000 euro në vitin 2017 dhe 2.000 euro në vitin 2018, me burim krijimi nga pagat e tij, duke e shlyer totalisht këtë hua.

21. Kredi për blerje automjeti në shumën 13.300 euro, kohëzgjatja 16.2.2012 – 16.1.2017, me këste mujore 282.59 euro, interesi euribor me maturim 6-mujor + 7.5%, sipas kontratës nr. ***, datë 30.1.2012. Likuiduar totalisht, vërtetuar me vërtetimin nr. ***, datë 6.1.2017, të lëshuar nga shoqëria “****” sh.a. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin nr. ***, datë 6.1.2017, nga shoqëria “****” sh.a., ku vërteton se ka financuar z. Adriatik Bocaj për blerjen e automjetit tip “Skoda Yeti”, në vlerën 13.300 euro, në datën 6.1.2017, detyrimi rezulton i shlyer²⁷.

21.1 Kjo kredi është trajtuar në pasurinë nr. *** në këto rezultate. Subjekti i rivlerësimit e ka shlyer totalisht këtë detyrim në datën 9.1.2017.

21.2 Komisioni kreu analizën për të parë mundësitë financiare të subjektit për shlyerjen e kësaj kredie nga viti 2013 deri në shlyerjen e kredisë në datën 9.1.2017.

21.3 Nga analiza financiare e kryer Komisioni konstatoi se dukej se subjekti nuk ka pasur mundësi në shumën 521.927 lekë dhe, më konkretisht, 237.464 lekë në vitin 2013, 124.028 lekë në vitin 2015 dhe 160.435 lekë në vitin 2016 për të shlyer kredinë, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

21.4 Subjekti ka prapësuar duke deklaruar se jetesa e tij është e thjeshtë, se ka si pasuri të paluajtshme vetëm një apartament të blerë në vitin 2000, i cili rrjedh më së shumti nga apartamenti i mëparshëm i privatizuar dhe në vazhdim ka blerë vetëm një automjet, të cilin e ka blerë me kredi dhe hua të shlyer ndër vite.

21.5 Në vijim ka parashtruar kundërshti lidhur me përlllogaritjet financiare sa i përket shpenzimeve (udhëtim, shkollim, TIMS) sidomos për transportin në qytetin e Lezhës ku, sipas tij, duhet të reduktohen për shkak të dublimit të këtyre shpenzimeve edhe si zë më vete edhe si pjesë e buxhetit të familjes mbi bazën e të cilave janë përlllogaritur shpenzimet jetike.

21.6 Subjekti ka qartësuar se ai në asnjë vit nuk ka deklaruar kursime *cash*. Ai ka qartësuar dhe kërkuar që pavarësisht se diferencat pozitive në vite nuk mund të përfshihen në analizën financiare (sipas praktikës së konsoliduar të Komisionit), por këtë fakt Komisioni duhet ta mbajë në vlerësim në kuadër të parimit të proporcionalitetit, pasi edhe pse nga ana e tij nuk është deklaruar asnjëherë gjendje *cash*, është e pamundur që një familje të mos ketë pasur asnjëherë në fund të vitit gjendje *cash*.

²⁷ Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

21.7 Sipas subjektit, Komisioni, për të vlerësuar këtë diferencë duhet të mbajë në vlerësim se kjo diferencë është rezultante e diferencave më të vogla në disa vite. Pjesa më e madhe e saj krijohet për shkak të shpenzimeve të udhëtimit që shpesh janë të dubluara dhe të përlllogaritura në mënyrë hipotetike, disa nga shpenzimet në vite janë përballuar edhe nga gjendja *cash* e akumuluar në vitin paraardhës, por për shkak të paqartësisë që ka pasur në lidhje me deklarin e kësaj gjendjeje, por edhe shumëve jo të larta të krijuara në fund të vitit është harruar pa deklaruar.

21.8 Subjekti ka cituar GJEDNJ-në e cila, në veçanti, në proceset në lidhje me vendosjen e masave disiplinore duhet të ketë një vlerësim të mjaftueshëm të proporcionalitetit të ndërhyrjes, duke pasur parasysh se masa përjashtuese e gjyqtarit nga sistemi gjyqësor përbën sanksionin disiplinor më të ashpër dhe më të rëndë në profesionin e tij, duke pasur pasoja të pakthyeshme për të. Arsyet në mbështetje të kësaj mase disiplinore duhet të jenë relevante dhe të mjaftueshme dhe sanksioni i vendosur në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur, duke cituar edhe vendime²⁸ të Strasburgut, Kolegjit e Komisionit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

21.9 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, arsyeton si vijon:

21.10 Lidhur me pretendimin e subjektit se në përlllogaritjet financiare për zërin e shpenzimeve të arsimit të vajzës ka dublim të tyre, trupi gjykues çmon se ky pretendim duhet të merret pjesërisht në konsideratë.

21.10.1 Shpenzimi i shkollimit të vajzës së subjektit rezultoi në vlerën 25.000 lekë sipas faturës për vitin 2015 dhe 25.000 lekë për vitin 2016. Trupi gjykues, referuar publikimeve të INSTAT-it në faqen zyrtare, anketës së buxhetit familjar²⁹ vëren se zëri arsim në vitin 2015 është 2.1% e shpenzimeve të jetesës dhe në vitin 2016 është 4.4%. Në raport me shpenzimet e jetesës për një person rezulton se në vlerë monetare, shpenzimet e arsimit për vitin 2015 janë në vlerën 4.710 lekë dhe për vitin 2016 në vlerën 10.344 lekë. Referuar të dhënave të dala, trupi gjykues konstaton se sipas dokumentacionit zyrtar, vlera prej 25.000 lekësh për vitet 2015 dhe 2016 është më e lartë sesa zëri arsim në ABF. Për këtë arsye, trupi gjykues ka marrë në konsideratë dokumentin zyrtar se sa është shpenzuar realisht për arsim, duke e bërë zbritje në të njëjtën kohë nga shpenzimet e jetesës vlerën 4.710 lekë për vitin 2015 dhe 10.344 lekë për vitin 2016.

21.11 Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të transportit për rrugën vajtje-ardhje në qytetin e Lezhës, në masën 7%, trupi gjykues arsyeton se sipas anketës së buxhetit familjar për vitin 2007, zëri i transportit zë 6.2% të shpenzimeve të jetesës për një person. Meqenëse nuk ka të dhëna sipas ABF-së deri në vitin 2014, trupi gjykues e ka përlllogaritur zërin e transportit me të njëjtën përqindje për të gjithë periudhën e analizuar 2007 – 2013. Trupi gjykues ka mbajtur të pandryshuar vlerën e deklaruar nga subjekti si të shpenzuar për transportin, por ka zbritur nga shpenzimet e jetesës për një person 6.2% të zërit të transportit, që korrespondon me vlerën 8.470 lekë për secilin nga vitet 2007 – 2011 dhe 8.743 lekë për secilin nga vitet 2012 – 2013.

²⁸ Ka cituar çështjen Xh. lidhur me shkarkimin nga detyra si një sanksion disiplinor i rëndë, i cili ndikon negativisht në jetën private të një individi dhe që kërkon marrjen në konsideratë të provave të forta që lidhen me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit (shihni çështjen Xh. § 403 dhe çështjen S. § 86), por edhe jurisprudencën e Komisionit dhe të Kolegjit (vendimi nr. 38, datë 6.12.2021; nr. 17/2022; nr. 2 JR, datë 2.2.2023; nr. 4 JR, datë 16.2.2023; nr. 19 JR, datë 10.6.2022) ku është konsoliduar qëndrimi se diferenca të tilla nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore.

²⁹ <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/#tab3>

21.12 Pas vlerësimeve të trupit gjykues në raport me pretendimet e subjektit, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu ripërlloraritjet dhe analiza financiare rezulton në balancat negative për vitet 2007 – 2008, 2013 dhe 2015 – 2016 në shumën 767.127 lekë. Duke mos konsideruar edhe huan e dhënë në vitin 2012 sipas arsyetimit të sipërcituar në total, balanca negative në total rezulton në vlerën 1.573.827 lekë³⁰.

21.13 Në vlerësimin përfundimtar, trupi gjykues, duke çmuar se mungesa e burimeve të ligjshme në vlerën 1.573.827 lekë është rezultat: (i) i shumës 767.127 lekë, e cila në vetvete është mbledhje e disa balancave negative të vogla të shpërndara ndër vite që ndikojnë shpenzimet e jetesës dhe jo krijimin e pasurive; (ii) i mosmarrjes në konsideratë të huas për shkak të deklarimeve kontradiktore të huadhënësit dhe jo drejtpërsëdrejti të subjektit, konkludon se ato nuk krijojnë bazë të mjaftueshme problematikash që e vënë subjektin në kushtet e mosarritjes së një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas ligjit nr. 84/2016, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, mbështetur edhe në jurisprudencën e krijuar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit³¹. Në vlerësimin e trupit gjykues, me problematikat e evidentuara nën dritën e këtyre parimeve, nuk justifikohet dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj.

DEKLARIM I BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT, F.B

22. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka plotësuar deklaratën *Vetting* dhe deklaroi se nuk disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj.

22.1 Komisioni kreu hetimin administrativ dhe nuk i kanë rezultuar pasuri të luajtshme apo të paluajtshme në emër të saj.

DEKLARIM I DJALIT TË SUBJEKTIT, D.B

23. Para në llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank. Krijuar nga puna. Vlera: 347.944 lekë. Zotërimi: 100%. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar: nxjerrje llogarie datë 20.1.2017, nga Raiffeisen Bank, në emër të D.B, me gjendje në datën 30.12.2016, në vlerën 347.944 lekë³².

23.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.

23.2 Nga korrespondenca me Raiffeisen Bank³³ konfirmohet llogari rrjedhëse me gjendje 347.944,12 lekë, në datën 23.1.2017, në emër të djalit të subjektit D.B.

23.3 Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.

24. Para në llogarinë rrjedhëse në Bankën Kombëtare Tregtare. Krijuar nga puna. Vlera: 27.588 lekë. Zotërimi: 100%. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar: nxjerrje llogarie datë 20.1.2017 nga BKT-ja, në emër të D.B, me gjendje në datën 16.1.2017, në vlerën 27.538 lekë³⁴.

24.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT-së.

³⁰ 767.127 lekë + 806.699 lekë.

³¹ Vendimet nr. 18/2021, nr. 26/2021, nr. 17/2022, nr. 19/2022.

³² Aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021.

³⁴ Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

24.2 Nga korrespondenca me Bankën Kombëtare Tregtare³⁵ konfirmohet llogari rrjedhëse me gjendje 27.538 lekë, në datën 23.1.2017, në emër të djalit të subjektit D.B.

24.3 Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

25. Para në llogarinë rrjedhëse në Tirana Bank. Krijuar nga puna. Vlera: 14.399 lekë. Zotërimi: 100%. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar: nxjerrje llogarie datë 20.1.2017, nga Tirana Bank, me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 14.399 lekë, transfertë llogarie D.B në Tirana Bank³⁶.

25.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Tirana Bank.

25.2 Nga korrespondenca me Tirana Bank³⁷ konfirmohet llogari rrjedhëse me gjendje 14.399,43 lekë, në datën 23.1.2017, në emër të djalit të subjektit D.B.

25.3 Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Tirana Bank.

- Të gjitha llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe djalit të tij janë si rezultat i marrëdhënieve të punës. Ato janë analizuar dhe janë pasqyruar në analizën financiare të përgjithshme të kryer nga Komisioni.

DEKLARIM I VAJZËS SË SUBJEKTIT, A.B

26. Vajza e subjektit të rivlerësimit ka plotësuar deklaratën *Vetting* dhe ka deklaruar se nuk disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj.

26.1 Komisioni kreu hetimin administrativ dhe nuk i kanë rezultuar pasuri të luajtshme apo të paluajtshme në emër të saj.

Gjetje të tjera

27. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti ka deklaruar se ka përfituar shumën 248.120 lekë nga Byroja Shqiptare e Sigurimit si pasojë e shkakut të dëmit në shumën 248.120 lekë.

Në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se: *“Kam përfituar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit shumën 248.620 lekë si dëmshpërblim për kartonin jeshil të makinës me targë ***, në emër të A.D si pasojë e aksidentit të ndodhur në datën 28.9.2010. Nga dëmi i shkaktuar makinës e kam rregulluar unë tek servisi, sipas faturës tatimore të dorëzuar tek Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe, për këtë shkak, pronari A.D më ka dhënë autorizim që shuma e dëmshpërblimit të më kalonte mua”.*

27.1 Komisioni i ka kërkuar³⁸ subjektit të deklarojë marrëdhënien me shtetasin A.D, për të cilin ka marrë prokurën e përfaqësimit në dëmshpërblimin e dhënë nga BSHS-ja, si dhe të dokumentonte nëse kishte zhvilluar ndonjë proces gjyqësor me palë ndërgjyqëse këtë shtetas apo si kërkues në secilin prej institucioneve ku ai ka ushtruar detyrën si gjyqtar e deri aktualisht.

27.2 Subjekti ka sqaruar se: *“Me këtë shtetas kam pasur marrëdhënie shoqërore (miqësie). Ky shtetas ka pasur në pronësi mjetin me targë ***³⁹ dhe më ka dhënë në përdorim të pjesshëm, për*

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 23.3.2021.

³⁶ Aneks nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 17.3.2021.

³⁸ Me pyetësorin nr. 3, datë 26.6.2023.

³⁹ Duket si lapsus pasi targa është *** sipas prokurës dhe dokumentacionit mbështetës.

*disa ditë në javë dhe për këtë kemi bërë së bashku policën e sigurimit (sigurimin ndaj te tretëve), vërtetuar kjo dhe nga e dhëna nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare AMF, ku del qartë që unë dhe kërkuesi kemi qenë bashkë në një policë sigurimi. ...Nga dëmi i shkaktuar makinës e kam rregulluar unë tek servisi, sipas faturës tatimore të dorëzuar tek Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe, për këtë shkak, pronari A.D më ka dhënë autorizim që shuma e dëmshpërblimit të më kalonte mua. Kjo shumë është kaluar në llogarinë time me nr. *** tek BKT-ja. Kjo shumë është deklaruar në ILDKPKI, në vitin 2011”.*

27.3 Subjekti, në mbështetje të deklarimit të tij, ka depozituar praktikën e përfitimit të shumës nga BSHS-ja, si dhe prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.4.2011, nga shtetasi A.D.

27.4 Nga aksesi i Komisionit në AMF rezulton polica e sigurimit e datës 14.9.2009 për automjetin me targë *** në emër të subjektit të rivlerësimit si përdorues dhe shtetasit A.D si pronar. Kjo është e vetmja policë ku figuron subjekti i rivlerësimit dhe pas kësaj date nuk rezulton asnjë policë tjetër për këtë mjet.

27.5 Nga aksesi në sistemin TIMS nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë dalë jashtë territorit të vendit me këtë automjet.

27.6 Komisioni nuk e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare, pasi ajo është shpenzuar për rregullimin e mjetit të dëmtuar. Në këtë rast efekti financiar është 0 (zero), pasi sipas praktikës së administruar subjekti i rivlerësimit ka kryer shpenzimin në shumën 248.120 lekë, ka depozituar faturën pranë BSHS-së dhe më pas është kompensuar për këtë shumë.

27.7 Në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksionit të tij dhe pronarit të automjetit, subjekti depozitoi përgjigjet e institucioneve punëdhënëse⁴⁰, të cilat konfirmojnë se ai nuk ka gjykuar çështje gjyqësore, ku palë ndërgjyqëse ose si kërkues të ketë qenë shtetasi A.D.

27.7.1 SPAK⁴¹ informon se në ngarkim të shtetasit A.D nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

27.8 Komisionit, nga verifikimi i të gjithë korrespondencës me DPPShtetit për sistemin TIMS, AMF-në dhe RNSH-në, nuk i rezultuan të dhëna dhe informacione të tjera përveçse atyre të konfirmuara dhe të deklaruara nga subjekti gjatë hetimit.

Konkluzion mbi vlerësimin e pasurisë

27.9 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas arsytimit dhe përfundimeve trajtuar në pikat 21.12 dhe 21.13 të këtij vendimi, trupi gjykues çmon se ato nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të tyre, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2023, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe shkresë nr. *** prot., datë 27.6.2023, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, depozituar me pyetësin nr. 3.

⁴¹ Me shkresën nr. *** prot., (D. B), datë 20.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

28. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (më parë DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 3.4.2023, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar: *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj.*

Hetimi i Komisionit

28.1 Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

28.2 Nga informacioni i përditësuar⁴² datë 29.6.2023, nga organet ligjzbatuese nuk rezultuan të dhëna të tjera lidhur me kontrollin e kriterit të figurës.

28.3 Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

28.4. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

29. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur një raport duke analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, referuar kriteret e mëposhtme të vlerësimit.

29.1 Raporti ka përshkruar dhe analizuar dokumentet e vlerësimit profesional të subjektit Adriatik Bocaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Raporti i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriteret e vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësive personale dhe angazhimit të tij profesional.

⁴² Me shkresën e SHISH-it nr. ***prot., datë 21.6.2022 dhe nr. *** prot., datë 29.6.2023, informohet se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme.

29.2 Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit të 3 dokumenteve ligjore⁴³ të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së; (iv) 3 dokumenteve ligjore⁴⁴ të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (v) 5 dosjeve gjyqësore⁴⁵ të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

29.2.1 Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai njeh parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se përgjithësisht ai identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes. Në çështjet administrative penale i kushton rëndësi zbatimit të kriterëve ligjore për arrestin në flagrancë dhe atyre për caktimin e masave të sigurimit. Ka njohuri të mira të procedurave të gjyqimit në raport me llojin e çështjeve gjyqësore civile apo penale që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e gjer tek arsyetimi i vendimit gjyqësor. Ndër 3 dokumentet e përzgjedhura dhe 5 dosjet e vëzhguara janë ankimuar 3 prej tyre. Në të tria rastet, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Përgjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për gjyqtarin Adriatik Bocaj janë paraqitur në Inspektoratin e ish KLD-së gjithsej 7 ankesa (1 në vitin 2013, 1 në vitin 2014, 3 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016). 2 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta. 5 ankesa janë verifikuar dhe ka rezultuar: 1 ankesë e verifikuar për shkelje procedurale penale, është vendosur tërheqja e vëmendjes me shkrim për gjyqtarin; 1 ankesë e verifikuar për shkelje etike është arkivuar, pasi nuk rezultuan shkelje dhe 3 ankesa të sugjeruara nga Inspektorati për verifikim, i janë dërguar për kompetencë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

⁴³ Dokumenti 1 – vendimi civil nr. ***, datë 11.2.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që u përket paditësve P. C e E. C, me të paditur Sh. C, me objekt “Lëshimin e urdhrin të mbrojtjes”; Dokumenti 2 – vendimi civil nr. ***, datë 20.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditëses V. M, me të paditur J. M, me objekt “Zgjidhjen e martesës ligjore”. Dokumenti 3 – vendimi administrativo-penal nr. *** akti, datë 20.10.2016, që i përket kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër personit nën hetim G. G, me objekt “Vleftësimin të ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

⁴⁴ Tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit janë dy të vitit 2014, vendimi civil nr. ***, datë 11.2.2014 dhe vendimi civil nr. ***, datë 20.10.2014 dhe një vendimi administrativo-penal nr. ***akti, datë 20.10.2016.

⁴⁵ Nga 5 dosjet e përzgjedhura me short, 4 dosje u vunë në dispozicion nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 1 dosje nga Gjykata e Lartë, gjer në datën 30.6.2020. Dosja 1 – çështja civile nr. *** regj., datë 7.4.2016, që i përket palës paditëse “****” sh.p.k., me të paditur “****” sh.p.k., me objekt “Detyrimin e të paditurit P. F të më paguajë shumën 2.155.550 lekë etj.”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 8.9.2016; Dosja 2 – çështja civile nr. *** regj., datë 30.4.2015, që i përket palës paditëse AKEP, kundër të paditurit A.H - *** sh.p.k., *** sh.p.k. e *** sh.p.k., me objekt “Detyrimin e të paditurve të paguajnë faturat e lëshuara nga AKEP, si detyrime të papaguara nga shërbimi telefonik fiks”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 10.7.2015. Dosja 3 – çështja civile nr. *** regj., datë 26.2.2014, që u përket kërkuarësve L. I e B. I, me objekt “Lëshimin e autorizimit për tjetërsim pasurie”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.3.2014. Dosja 4 – çështja civile nr. *** regj., datë 20.1.2015, që i përket paditëses Sh. N, me të paditur H. N, me objekt “Zgjidhjen e martesës”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 2.3.2015. Dosja 5 – çështja administrativo-penale nr. *** regj., datë 7.10.2016, që i përket kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër të arrestuarit S. Q, i akuzuar për veprën penale “Dhunë në familje”, me objekt “Vleftësimin të ligjshëm të arrestit në flagrancë” dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 8.10.2016.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme, por ndonjëherë tepër shkurt. Në përgjithësi respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, por nuk i ka përdorur gjithmonë të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe në përgjithësi e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil apo kërkesat e legjislacionit procedural penal. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziton lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, por nuk plotësohet me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë. Një konstatim i punës së tij është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, pa përdorur fjali të përgjithshme apo arsyetim i tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar vendim nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët. Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar shkakun, por jo gjithmonë edhe bazën ligjore.

29.2.2 Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, njëkohësisht në dhomën civile e atë penale. Ai ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 1890 çështje, ka përfunduar gjithsej 1675 çështje për tre vjet, si dhe nuk ka mbartur në vitin 2017 - 96 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 88,6 %. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtari Adriatik Bocaj ka përfunduar gjithsej 1479 çështje gjyqësore, nga të cilat 1303 çështje civile (325 civile të përgjithshme me palë kundërshtare, 467 çështje familjare dhe 511 kërkesa civile) dhe 176 çështje penale (1 penale themeli e 175 masa sigurimi). Sipas pikës 3, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në një vit, në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështje civile me palë kundërshtare. Sipas të dhënave statistikore, konstatohet se ngarkesa sasiore e gjyqtarit Adriatik Bocaj ka qenë mbi standardin minimal. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Adriatik Bocaj ka qenë gjithnjë brenda afateve standarde apo ligjore dhe në intervale kohore nga 1 ditë deri në 5 muaj e 1 ditë. Në tri dosjet e tjera kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 20 ditë, 2 muaj e 3 ditë dhe 19 ditë. Në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se është respektuar

standardi i procesit të rregullt ligjor. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari Adriatik Bocaj i kushton gjithmonë rëndësi arsytimit në kohë të shpejtë të vendimeve, duke i dorëzuar dosjet të arsyetuara brenda afateve ligjore. Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtari Adriatik Bocaj ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ai ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal, por gjithmonë i ka kushtuar rëndësinë e duhur gjykimet brenda afateve dhe arsytimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Adriatik Bocaj ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në 4 çështjet civile të vëzhguara, ai ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore. Në këto 4 raste, veprimet përgatitore kanë qenë efektive, i kanë shërbyer ecurisë pa vonesa të gjykimit dhe janë dokumentuar gjithmonë me procesverbal të rregullt nga pikëpamja formale. Në 4 çështjet civile, gjykimet kanë përfunduar me 2, 3, 5 deri 7 seanca. Ndërsa çështja administrativo-penale e vëzhguar, që lidhet me kërkesën për vleftësim të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal, ka përfunduar me 1 seancë. Konkretisht janë vëzhguar 18 seanca gjyqësore, nga të cilat 14 kanë qenë produktive. Pengesë në 4 seanca joproduktive kanë qenë; mosparaqitja e palëve ndërgjyqëse (1 seancë), caktimi i seancës në ditë feste zyrtare (1 seancë), mosparaqitja e palës së paditurit (1 seancë) dhe mosformimi i trupit gjykues (1 seancë). Gjatë gjykimit, subjekti i rivlerësimit identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimet përfundimtare të palëve e gjer tek shpallja e vendimit. Në gjykimin e kërkesës administrativo-penale, data për seancën e parë është caktuar menjëherë pas paraqitjes së kërkesës, siç është parashikuar nga neni 258 i Kodit të Procedurës Penale.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile dhe ato penale. Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha procesverbalet, të seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje, rezulton se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera. Gjithashtu, të gjitha procesverbalet rezultojnë të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe nga gjyqtari, konform kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale. Procesverbali gjyqësor në formatin letër dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në asnjë rast të çeljes së seancës gjyqësore nuk është konstatuar vonesë në procesverbal, por konstatohet gjithashtu se nga 18 seancat gjyqësore të 5 dosjeve të vëzhguara ka rezultuar se vetëm 3 prej tyre janë dokumentuar me regjistrim audio, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim. Çmujmë lidhur me këtë, se mund të ketë ndikuar edhe gjendja e infrastrukturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me numrin e pamjaftueshëm të sallave të gjykimit. Dosjet kanë rezultuar të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e palëve ndërgjyqëse e më pas aktet e gjykatës, me përjashtim të dosjes 4 që nuk ishte sistemuar në mënyrë kronologjike. Megjithatë të gjitha dosjet rezultojnë të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët.

29.2.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore nuk rezulton të ketë ardhur ndaj tij ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Adriatik Bocaj.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Adriatik Bocaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

29.2.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Adriatik Bocaj komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesë për përjashtim të gjyqtarit dhe as kërkesa të vetë gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në 8 raste, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar i vetëm për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ai ka marrë pjesë në 13 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 25 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve ku ai ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale. Subjekti i rivlerësimit Adriatik Bocaj ka deklaruar se jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës ka marrë pjesë në kursin “Njohuri fillestare për kompjuterin”, duke bashkëlidhur certifikatën e dhënë nga instituti “***”.

C/1. RIVLERËSIMI PROFESIONAL

30. Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, sa u përket tri dokumenteve⁴⁶ të vëna në dispozicion nga subjekti:

- i) nuk konstatoi shkelje procedurale;
- ii) konstatoi se dy vendimet gjyqësore të subjektit, përkatësisht me nr. ***, datë 11.2.2014, me objekt “Lëshim i urdhrin të mbrojtjes” dhe nr. ***, datë 20.10.2014, me objekt “Zgjidhje e martesës ligjore”, pas ankimit të ushtruar nga Gjykata e Apelit Tiranë, kanë mbetur në fuqi;
- iii) Sa i përket vendimit administrativ-penal nr. *** akti, datë 20.10.2016, me objekt “Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit arrest në burg”, sipas shpjegimit të dhënë nga subjekti⁴⁷ rezultoi se është ushtruar ankim nga avokati i personit nën hetim dhe se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr. ***, datë 1.11.2016, ka vendosur miratimin e vendimit penal (masë sigurimi) nr. ***, datë 20.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Subjekti ka depozituar kërkesën ankimore, si dhe vendimet përkatëse të gjykatave. Nga verifikimi i tyre nuk vërehen problematika.

30.1 Në lidhje me pesë dosjet⁴⁸ e shortuara nëpërmjet një sistemi rastësor, për të cilat është konkluduar në raportin e KLGJ-së, Komisioni nga verifikimi përkatës, ashtu sikurse ka konkluduar edhe raporti i këtij të fundit, konstatoi se vetëm në një rast (që i përket vendimit nr. ***, datë 8.9.2016, të subjektit) është ushtruar e drejta ankimore dhe, më tej, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e subjektit të rivlerësimit, ndërsa në katër rastet e tjera që u përkasin dosjeve të renditura me nr. 2, 3, 4 dhe 5 nuk është ushtruar e drejta ankimore nga palët.

30.2 Konstatohet se për të tria dokumentet e dorëzuara nga subjekti dhe pesë dosjet e shortuara tregohet në dispozitivin e vendimit se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore dhe, po ashtu, tregohet e drejta e afatit të ankimit për palët ndërgjyqëse.

30.3 Përgjithësisht, nga verifikimi i kohëzgjatjes së gjyqësorëve të çështjeve dhe dorëzimit të vendimeve të arsyetuara nga subjekti i rivlerësimit nuk vërehen problematika.

30.4 Ankesat - Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultoi se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, për gjyqtarin Adriatik Bocaj janë paraqitur gjithsej 7 ankesa (1 në vitin 2013, 1 në vitin 2014, 3 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së, ku 2 ankesa janë arkivuar

⁴⁶ i) Vendimi civil nr. ***, datë 11.2.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që u përket paditësve P. C e E. C (gjeneralitetet), me të paditur Sh. C (gjeneralitetet), me objekt “Lëshimin e urdhrin të mbrojtjes”. Kodi i Procedurës Civile dhe ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”; ii) Vendimi civil nr. ***, datë 20.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditëses V. M (gjeneralitetet), me të paditur J. M (gjeneralitetet), me objekt “Zgjidhjen e martesës ligjore”, neni 132 Kodi i Familjes; iii) Vendimi administrativo-penal nr. *** akti, datë 20.10.2016, që i përket kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër personit nën hetim G. G (gjeneralitetet), me objekt “Vleftësimin të ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

⁴⁷ Me pyetësin nr. 3, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁸ Dosja 1 - Çështja civile nr. *** regj., datë 7.4.2016, që i përket palës paditëse *** sh.p.k., me të paditur “****” sh.p.k., me objekt “Detyrimin e të paditurit P. F të më paguajë shumën 2 155 550 lekë etj.”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 8.9.2016. Dosja 2 - Çështja civile nr. *** regj., datë 30.4.2015, që i përket palës paditëse AKEP, kundër të paditurit A.H - *** sh.p.k., *** sh.p.k. e *** sh.p.k., me objekt “Detyrimin e të paditurve të paguajnë faturat e lëshuara nga AKEP, si detyrime të papaguara nga shërbimi telefonik fiks”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 10.7.2015. Dosja 3 - Çështja civile nr. *** regj., datë 26.2.2014, që u përket kërkesësve L. I e B. I, me objekt “Lëshimin e autorizimit për tjetërsim pasurie”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.3.2014. Dosja 4. Çështja civile nr. *** regj., datë 20.1.2015, që i përket paditëses Sh. N, me të paditur H. N, me objekt “Zgjidhjen e martesës”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 2.3.2015. Dosja 5 - Çështja administrative-penale nr. *** regj, datë 7.10.2016, që i përket kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të arrestuarit S. Q, i akuzuar për veprën penale “dhunë në familje”, me objekt “Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë” dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, e përfunduar me vendimin nr. (***), datë 8.10.2016.

(1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) pas shqyrtimit paraprak, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta.

- Nga verifikimi i pesë ankesave, sikurse është konkluduar nga raporti, rezultoi se:

i) për 1 ankesë të vitit 2013⁴⁹, e verifikuar për shkelje procedurale penale, është vendosur tërheqja e vëmendjes me shkrim për gjyqtarin;

- Komisioni administroi informacionin e KLGj-së⁵⁰, së bashku me praktikën shoqëruese që i përket ankesës së vitit 2013, e verifikuar për shkelje procedurale penale, pas së cilës thuhet se ishte vendosur tërheqja e vëmendjes me shkrim për gjyqtarin Bocaj.

Nga dokumentacioni i administruar (ku renditet edhe vendimi i subjektit nr. ***, datë 7.4.2009) rezultoi se ankesa është vënë në lëvizje në KLD nga shtetasi F.P, i cili ka pretenduar se gjyqtari Bocaj kishte dhënë vendim mbi kërkesën e tij, pa zhvilluar seancë gjyqësore. Pretendimet e z. P i referohen gjykimit të zhvilluar mbi një kërkesë të depozituar prej tij në Gjykatë me objekt “Kundërshtim i vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***”.

- Nga verifikimi i kryer prej grupit të inspektorëve të KLD-së, në ndryshim nga sa ka pretenduar ankuesi, ka rezultuar se ai në zhvillimin e seancës së parë gjyqësore, në prani të gjykatës dhe prokurorit të çështjes, ka kërkuar pushimin e çështjes, kërkesë kjo e pasqyruar në procesverbalin përkatës, pas së cilës është vendosur pushimi i çështjes.

Por inspektimi ka rezultuar në të tjera shkelje procedurale përgjatë verifikimit të dokumentacionit të administruar dhe, më konkretisht, duke iu referuar vendimit të pushimit të çështjes, nr. ***, datë 7.4.2009, grupi i inspektimit ka konstatuar se subjekti ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes administrative penale, bazuar në nenin 126 dhe 229 të Kodit të Procedurës Civile, ndërkohë që duhet të ishte bazuar në rregullimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale, si dhe ka përcaktuar parashikimin e gabuar të afatit të ankimit, duke i njohur palëve të drejtën ankimore brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit, në kundërshtim me nenin 415 të Kodit të Procedurës Penale, ku kjo e drejtë njihet dhe ushtrohet brenda afatit 10-ditor. Për shkeljet e konstatuara grupi i inspektimit ka çmuar që gjyqtarit t’i tërhiqet vëmendja me shkrim dhe rezultatet të kihen parasysh në vlerësimin profesional dhe etik të tij për vitet 2007 – 2009, pasi këto shkelje nuk kanë sjellë pasojë në rastin konkret dhe nuk kanë qenë të mjaftueshme për të nisur një procedim disiplinor ndaj tij.

ii) për 1 ankesë të vitit 2016, e verifikuar për shkelje etike, është bërë arkivimi i saj, pasi nuk kanë rezultuar shkelje, dhe;

iii) për 3 ankesa (2 të vitit 2015⁵¹ dhe 1 e vitit 2016⁵²) të sugjeruara nga Inspektorati për verifikim i janë dërguar për kompetencë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

ILD-ja⁵³ ka përcjellë informacion lidhur me këto tri ankesa, për të cilat konfirmon se është vendosur arkivimi i tyre dhe njëkohësisht ka përcjellë edhe dokumentacionin shoqërues.

a. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se ankuesi M.K i është drejtuar ish-KLD-së me ankesën nr. *** prot., datë 30.12.2015⁵⁴. Q.K i është drejtuar ish-KLD-së me ankesën nr. *** prot., datë 5.6.2015 dhe ankuesi/avokat I.N i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe ish-KLD-së me ankesën nr. *** prot., datë 17.9.2015 dhe nr. *** prot., datë 12.10.2015.

Të tria ankesat janë arkivuar me vendim të Inspektorit të Lartë të ILD-së për shkak të parashkrimit, pasi referojnë fakte të ndodhura jashtë afatit të parashkrimit.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.11.2013, sipas të dhënave të raportit të vlerësimit profesional.

⁵⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2023, administruar së bashku me praktikën shoqëruese në dosjen e Komisionit.

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2015 dhe nr. *** prot., datë 30.12.2015, sipas të dhënave të administruara në raportin e vlerësimit profesional.

⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 6.5.2016, sipas të dhënave të administruara në raportin e vlerësimit profesional.

⁵³ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁴ Regjistruar në KLD me nr. *** prot., datë 1.2.2021.

Në vendimin e ILD-së nr. *** prot., datë 22.12.2022 “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. M.K”, vërehet se ankuesi ka pretenduar për zvarritje të gjykimit, që i përket çështjes civile nr. ***, datë 13.5.2015, të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me paditës M.K, të paditur znj. L.Z, me objekt “Lirim e dorëzim sendi të objektit të dhënë me qira, sipas kontratës...”, çështje kjo e shortuar pranë gjyqtarit/subjektit. Në thelb, pretendimet e ankuesit kanë të bëjnë me zvarritjen e gjykimit. Po në vendimin e arkivit të ankesës thuhet se nga subjekti janë zhvilluar 7 seanca, të cilat i përkasin fazës përgatitore. Në seancën e datës 2.10.2015, pala paditëse/ankuesi ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit/subjektit. Në datën 15.10.2015 është vendosur përjashtimi i gjyqtarit nga ky gjykim.

Në vendimin e ILD-së nr. *** prot., datë 26.1.2023, që i përket arkivimit të ankesës së znj. Q.K, sërish në thelb qëndron pretendimi për zvarritje të gjykimit.

Në vendimin e ILD-së nr. *** prot., datë 22.5.2023, që i përket arkivimit të ankesës së ankuesit/avokatit I.N, konstatohet se pretendimet i referohen mosnjoftimit të palës së paditur V.G, të cilën ai e ka përfaqësuar në një çështje gjyqësore me objekt “Zgjidhje martesë”. Në këtë rast, avokati ankohet se pala e paditur nuk është njoftuar rregullisht dhe, për pasojë, gjyqtari/subjekti ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor.

30.5 Në lidhje me 3 ankesa (2 të vitit 2015 dhe 1 të vitit 2016), Komisioni i kërkoi subjektit: i) të shpjegonte dhe dokumentonte për të provuar të kundërtën e pretendimeve të ankuesve M.K dhe L.K për zvarritje të gjykimit; ii) të shpjegonte dhe dokumentonte lidhur me pretendimin e avokatit I.N se kishte zhvilluar gjykimin e zgjidhjes së martesës me palë të paditur shtetasen V.G pa e njoftuar rregullisht atë; e iii) të dokumentonte statusin e vendimmarrjeve të tij në lidhje me këto tri ankesa (në rastet kur gjykimi i çështjes kishte përfunduar prej tij).

30.6 Në qëndrimin e tij, subjekti ka parashtruar sipas akteve në dosje gjithë procedurën⁵⁵ e ndjekur dhe vendimin e marrë për zgjidhjen e çështjes civile me palë shtetasen Q.K, duke depozituar kopjen e plotë të dosjes, ka sqaruar edhe statusin e vendimmarrjes, e cila është ankimuar dhe është për gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Subjekti ka shpjeguar se për këtë çështje ankuesi është ankuar edhe në ILD për zvarritje gjykimi. ILD-ja, me vendimin nr.***, datë 26.1.2023, ka vendosur arkivimin e saj, duke depozituar edhe këtë dokument.

30.7 Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit (akte nga dosja gjyqësore), konstaton se çështja duket të ketë qenë komplekse, ku janë depozituar padi e kundërpadi, është kërkuar bërja e aktit të ekspertimit, është kërkuar shtesë në aktin e ekspertimit, ka pasur problematika në lidhje me pagesën e ekspertit, provohet se të gjitha seancat janë shtyrë me kërkesë të vetë palëve ndërgjyqëse etj. Rezulton se gjykimi ka zgjatur për 9 muaj dhe se çështja është në gjykim në Gjykatën e Apelit. Në tërësi për këtë çështje trupi gjykues i çmon të qarta dhe bindëse shpjegimet e subjektit, duke mos konstatuar ndonjë problematikë që mund të ndikojë në cenimin e kriterit profesional.

30.8 Lidhur me pretendimet e ankuesve M.K dhe L.K, subjekti në qëndrimin e tij ka parashtruar sipas akteve në dosje gjithë procedurën⁵⁶ e ndjekur dhe vendimin e marrë për zgjidhjen e çështjes civile, duke depozituar kopjen e plotë të dosjes⁵⁷ dhe sqaruar edhe statusin e saj. Subjekti ka parashtruar se për këtë çështje ankuesi është ankuar edhe në ILD për zvarritje të gjykimit. ILD-ja, me vendimin nr. ***, datë 22.12.2022, ka vendosur arkivimin e saj.

30.9 Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit (akte nga dosja gjyqësore), konstaton se seancat janë shtyrë me kërkesë të palëve, është kërkuar nga pala paditëse shtyrje seance për arsye të tyre, gjithashtu është kërkuar po nga pala paditëse përjashtimi i gjyqtarit/subjektit dhe, për pasojë, seanca e radhës ka marrë kohë, është vendosur përjashtimi dhe, më pas, çështja është gjykuar nga një tjetër gjyqtar. Rezulton se në procesverbalet e mbajtura, pjesë e dosjes gjyqësore, pasqyrohen arsyet e shtyrjes së seancave. Aktualisht, çështja ndodhet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për gjykim, pra në proces. Në përfundim, trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të tjera të subjektit të rivlerësimit, por edhe nisur nga fakti që ankesa lidhur pikërisht me këtë çështje është

⁵⁵ Referojuni parashtrimeve të detajuara të subjektit.

⁵⁶ Referojuni parashtrimeve të detajuara të subjektit.

⁵⁷ Gjithsej 163 fletë.

arkivuar nga ILD-ja, pasi nuk janë konstatuar shkelje ligjore, konkludon se nuk konstatohen shkelje etiko-procedurale apo mangësi profesionale nga subjekti për sa i përket kësaj çështjeje.

30.10 Lidhur me pretendimin e ankuesit, avokatit I.N, subjekti në qëndrimin e tij ka parashtruar procedurën e ndjekur dhe vendimin e marrë për zgjidhjen e çështjes familjare me palë paditëse SH.G dhe të paditur V.G, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, e dokumentuar në procesverbalet përkatëse. Rezulton se vendimi nr. ***, datë 7.7.2015, është ankimuar nga përfaqësuesi i palës së paditur në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 8.6.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 7.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për këtë çështje ankuesi është ankuar edhe në ILD për proces jo të rregullt. ILD-ja, me vendimin nr. ***, datë 22.5.2023, ka vendosur arkivimin e saj. Subjekti ka depozituar kopje të plotë të dosjes dhe vendimin nr. ***, datë 22.5.2023, të ILD-së.

30.11 Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit (sipas akteve në dosjen gjyqësore), konstaton se shumica e shtyrjes së seancave ka ardhur si pasojë e mosmarrjes pjesë në to nga vetë ankuesi/avokati, i cili edhe i është drejtuar me ankesë ILD-së për zvarritje të procesit gjyqësor. Rezulton se vendimi i subjektit është ankimuar dhe ka mbetur në fuqi në Apel. Në tërësi, edhe për këtë çështje trupi gjykues nuk konstaton problematikë, që mund të ndikojë në cenimin e kriterit profesional.

30.12 Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Adriatik Bocaj përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të jetë përcjellë ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe as të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

30.13 SPAK⁵⁸ nuk ka konfirmuar ndonjë procedim penal të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

➤ **Në lidhje me denoncimet⁵⁹ e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, trajtuar si më poshtë:**

31. Denoncim⁶⁰ i shtetasit P.D.LL

31.1 Denoncuesi ka kallëzuar penalisht për “shpërdorim detyre me dashje” shumë prokurorë dhe gjyqtarë, pjesë e procesit të hetimit dhe gjykimit të një konflikti pronësie. Denoncuesi nuk paraqet asnjë fakt apo rrethanë që cenon pozitën e subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi ka depozituar ***, datë 16.7.2008, me palë ndërgjyqëse paditësit GJ.LL dhe P.LL dhe palë të paditur Bashkia M etj., me objekt “Pavlefshmëri e veprimeve juridike dhe akteve administrative”, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes gjyqësore, ku nga verifikimi i vendimit Komisioni konstatoi se në seancën gjyqësore, datë 16.7.2008, vetë paditësi/denoncuesi ka kërkuar pushimin e gjykimit të çështjes, nën pretendimin se do e zgjidhte çështjen në rrugë të tjera ligjore. Denoncuesi nuk paraqet pretendime lidhur me këtë vendim.

31.2 Komisioni, në bazë të dokumentacionit të administruar, konstatoi se nuk vihet re ndonjë fakt apo rrethanë, që mund të përbëjë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

32. Denoncim⁶¹ i shtetasit A.Z

32.1 Denoncuesi ankohet kundrejt subjektit të rivlerësimit për shkelje të procedurës dhe paaftësi profesionale gjatë procesit gjyqësor. Denoncuesi ka sqaruar fillimisht se ai ka zgjidhur martesën prej vitit 2012 dhe, ndërkohë, rreth tri vite pas këtij gjykimi, ka mësuar se i është hequr e drejta prindërore mbi djalin e tij. Denoncuesi pretendon se si palë e paditur në këtë proces gjykimi nga subjekti i rivlerësimit nuk është njoftuar në adresën zyrtare, në kundërshtim me nenin 128 të Kodit të Procedurës Civile dhe se vendimi gjyqësor nr. ***, datë 12.5.2015, i depozituar prej tij, është marrë në mungesë të tij.

⁵⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2023.

⁵⁹ Janë paraqitur katërmëdhjetë denoncime, ku një prej denoncuesve ka depozituar dy denoncime të përsëritura me të njëjtin objekt ankimi.

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 8.1.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶¹ Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

Denoncuesi ka sqaruar se ka rivendosur në afat të drejtën e ankimit për vendimin e marrë në mungesë të tij, vendim i cili ka mbetur në fuqi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

32.2 Komisioni administroi⁶² vendimin gjyqësor nr. *** akti, datë 27.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Rivendosje në afat”, me kërkesë denoncuesin dhe person të tretë ish-bashkëshorten e tij, V.P, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 18.9.2018, të Gjykatës së Apelit.

32.3 Nga verifikimi i vendimit rezultoi se kërkesa e z. Z është pranuar dhe, për pasojë, është rivendosur në afat e drejta e ankimit ndaj vendimit të heqjes së përgjegjësisë prindërore, vendosur më parë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor/nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 12.5.2015. Sipas arsytimit të vendimit të rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit, duket se pranimi i kërkesës ka marrë shkas nga mosprezenca e pajustificuar e të paditurit/denoncuesit në procesin gjyqësor, me objekt “Heqje e përgjegjësisë prindërore”, me paditëse ish-bashkëshorten e denoncuesit. Denoncuesi ka pretenduar se është dhënë adresë e pasaktë nga ish-bashkëshortja në kërkesën për heqje të përgjegjësisë prindërore dhe se nuk i janë komunikuar fletëthirrjet.

32.4 Komisioni administroi⁶³ vendimin gjyqësor nr. ***, datë 12.5.2015, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, me objekt “Heqje e përgjegjësisë prindërore”.

i. Nga verifikimi i vendimit rezultoi se i padituri/denoncuesi ka qenë në mungesë në këtë proces gjyqësor.

Komisioni administroi⁶⁴ dosjen gjyqësore me objekt “Rivendosje në afat e të drejtës së ankimit”.

ii. Nga verifikimi i akteve në dosje rezultoi se paditësja ka përcaktuar në padi si adresë të të paditurit të njëjtën adresë të përcaktuar në padinë me objekt “Zgjidhje martesë”.

iii. I padituri në këtë proces gjyqësor rezultoi të ketë qenë në mungesë.

iv. Duke iu referuar arsytimit të gjykatave në çështjen me objekt “Rivendosje në afat”, vërehet se nuk janë konstatuar shkelje procedurale të subjektit, por duket si vlerësim i gjykatave në kuadrin e dhënies së një mundësie për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë.

v. Në drejtim të ndjekjes nga gjykata/nga subjekti i rivlerësimit të veprimeve procedurale lidhur me këtë çështje objekt gjykimi nga aktet rezultoi:

a. Me procesverbalin datë 16.2.2015, rezultoi se paditësja, krahas adresës së konfirmuar në padi, adresë e njëjtë me atë të konfirmuar në padinë me objekt “Zgjidhje martesë”, ka konfirmuar për gjykatën edhe një adresë tjetër, ku të paditurit Z. mund t’i dërgohej njoftimi, B. Rrethina Shkodër, kërkesë gjithashtu e pranuar nga gjykata.

b. Me procesverbalin datë 16.3.2015, paditësja pas pyetjes së gjykatës (sipas së cilës sërish nuk është arritur të njoftohet i padituri) ka kërkuar të vijojë gjykimi me shpallje, pasi i padituri është larguar nga adresat që ajo kishte konfirmuar, duke kërkuar gjithashtu që njoftimi me shpallje t’i bëhej sërish në të dyja adresat, kërkesë kjo e pranuar nga gjykata. Nga aktet rezultoi se fletëthirrjet janë dërguar në të dyja adresat.

c. Pra, në këtë rast, gjykata ka zbatuar edhe mënyrën e njoftimit sipas nenit 133/2 të Kodit të Procedurës Civile, duke dërguar fillimisht fletëthirrje dhe, më pas, njoftimin me shpallje edhe në adresë të biznesit sipas QKR-së (depozituar ekstraktet e QKR-së nga paditësja që në çështjen gjyqësore me objekt “Zgjidhje martesë”).

ç. Në përshkrimin e zhvillimit të procesit gjyqësor, gjykata ka cilësuar të drejta pretendimet dhe faktet e paraqitura nga paditësja V. P kundrejt ish-bashkëshortit të saj, A. Z. Ajo ka treguar me fakte dhe prova se në rritjen e djalit të tyre ajo ka qenë e vetme. Shtetasi A. Z nuk ka përmbushur asnjë pagesë detyrimi ushqimor ndaj djalit të tyre, nuk ka bërë asnjë takim me djalin, nuk është interesuar asnjëherë për të, nuk ka

⁶² Me shkresën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nr. *** prot., datë 30.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶³ Me shkresën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nr. *** prot., datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁴ Me shkresën e Gjykatës së Lartë, nr. *** prot., datë 11.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

respektuar asnjë afat apo detyrim të dhënë në vendimin gjyqësor të zgjidhjes së martesës. Në dosje është administruar një korrespondencë e gjatë e përmbaruesit gjyqësor për ekzekutimin e vendimit të zgjidhjes së martesës, i cili kishte vendosur disa detyrime të z. Z ndaj fëmijës së mitur, ekzekutim i cili ishte bërë i pamundur për t'u realizuar dhe, për këtë shkak, ishte pushuar.

Edhe në kërkesën e z. Z për të rivendosur çështjen në afat ankimi, duket se prej tij është anashkaluar fakti i ndërmarrjes së veprimeve mbi detyrimet që i kishte vendosur gjykata ndaj fëmijës së mitur, por prezantohet thjesht dhe vetëm interesimi për t'u ankuar mbi çështjen e heqjes së përgjegjësisë prindërore.

32.5 Komisioni administroi⁶⁵ dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 18.5.2012, me objekt "Zgjidhje martesë" (shqyrtimi i zgjidhjes së martesës është bërë nga një tjetër subjekt rivlerësimi, M. Ll). Më poshtë prezantohet një historik mbi gjykimin e kësaj çështjeje, duke qenë se tri objektet civile familjare kanë lidhje mes tyre dhe vijnë si pasojë e njëra-tjetrës. Nga aktet e kësaj dosjeje, Komisioni konstatoi se shtetasit V.P dhe A.Z e kanë zgjidhur martesën në vitin 2012. Në vendimin nr. ***, datë 18.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përcaktuar se ky vendim është marrë në mungesë të palës së paditur, shtetasit A. Z. Në procesverbalet e mbajtura nga Gjykata, në zbatim të nenit 129 dhe 133⁶⁶ të Kodit të Procedurës Civile, është kryer njoftimi i shtetasit A. Z në adresën e banimit Tiranë, ***, rruga "****", pallati "****", shkalla ***, kati ***, adresë kjo ku bashkëjetonin sipas përcaktimit të paditëses në padi.

Gjykata ka ndjekur procedurën e njoftimit deri me shpallje në ambientet e gjykatës dhe në adresën e vendbanimit të A. Z. Në procesverbalet e mbajtura në seancat përgatitore konstatohet se paditësja ka dorëzuar dy ekstrakte regjistrimi tregtar të marrë në QKR⁶⁷ dhe një vërtetim të dhënë nga Njësia Administrative Nr. *** Tiranë, datë 16.5.2012, ku cilësohet se shtetasi A. Z nuk banon në adresën e deklaruar, që nga korriku 2010.

Nga aktet rezultoi se shtetasi A. Z nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të zgjidhjes së martesës.

Për këtë çështje është pyetur⁶⁸ edhe subjekti i rivlerësimit. Në përgjigjen e dhënë subjekti ka renditur të gjithë procedurën e ndjekur prej shortimit të saj në mënyrë elektronike, në datën 3.2.2015 e në vijim, arsyet e zhvillimit të procesit në mungesë të palës së paditur, duke ndjekur procedurën e njoftimit deri me shpallje, si dhe ka qartësuar lidhur me ankesën e depozituar nga denoncuesi po për këtë çështje edhe në ILD. Subjekti ka depozituar kopje të dosjes gjyqësore me objekt "Heqje e përgjegjësisë prindërore", si dhe kopje të njoftimit të vendimit të arkivimit të ankesës së z. Z/denoncuesit nga ILD-ja ndaj subjektit të rivlerësimit.

32.6 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, pasi konstatoi se nuk ishte aplikuar as neni 133/3⁶⁹ i Kodit të Procedurës Civile në shpalljen e bërë palës së paditur/denoncuesit.

⁶⁵ Me shkresën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nr. *** prot., datë 10.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁶ Neni 129 - *Thirrja në gjykatë bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjes, e cila duhet të përmbajë gjykatën që e ka nxjerrë, emrin, mbiemrin e personit të thirrur, kohën e vendin e seancës gjyqësore, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, si dhe pasojat ligjore në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë. Gjykata, kur e çmon të dobishme dhe kur pala ka dhënë pëlqimin paraprak, urdhëron që thirrja në gjykatë të bëhet nëpërmjet njoftimit me mjete të komunikimit elektronik, sipas rregullave të përcaktuara në këtë kre.*

Neni 133 (ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008, neni 4; ndryshuar me ligjin nr. 122/2013) – *"Kur personit të thirrur nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, ose nuk ka zgjedhur një banesë, apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij, sipas nenit 131 të këtij Kodi, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në gjykatën e vendit, ku do të gjykohej mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit, ku ka pasur vendbanimin e fundit. Ky njoftim qëndron i afishuar për jo më pak se 20 ditë. Në rastin kur marrësi është person juridik privat, njoftimi bëhet nëpërmjet afishimit të tij pranë adresës së qendrës së regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ose në regjistrin e organizatave jofitimprurëse. Në këto raste, njoftimi i aktit bëhet edhe në një rubrikë të posaçme, në faqen zyrtare në internet të gjykatës, ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim."*

⁶⁷ Shoqëria *** sh.p.k., me NIPT ***, me seli në K Shkodër, me status aktiv edhe sot, dhe shoqëria ***, me NIPT ***, me seli në B e M, B, Shkodër, status aktiv, ku në të dyja shoqëritë rezultoi se shtetasi A. Z është përfaqësues ligjor dhe ortak i vetëm.

⁶⁸ Me pyetësin nr. 4, datë 7.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁹ *"Në këto raste, njoftimi i aktit bëhet edhe në një rubrikë të posaçme, në faqen zyrtare në internet të gjykatës ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim."*

32.7 Në qëndrimin e tij, subjekti ka pasqyruar të gjithë procedurën e ndjekur dhe vendimin e marrë në lidhje me pretendimin e shtetasit A.Z, informacion i bazuar në aktet e dosjes gjyqësore.

Sipas subjektit, njoftimi në faqen zyrtare në internet të gjykatës është detyrë e sekretarisë gjyqësore për të çuar njoftimin tek IT-ja, i cili i hedh në faqen e internetit. Në rastin konkret, gjykata, që shpallja të jetë sa më efikase, e ka njoftuar edhe në vendbanimin e prindërve të tij. Për të gjitha veprimet e gjyqtarit ankuesi është ankuar edhe në ILD, e cila ka dhënë vendimin nr. ***, datë 20.4.2023, duke sqaruar të gjitha pretendimet e ankuesit deri në arkivimin e çështjes. Subjekti ka depozituar kopje të dosjes, vendimin e kalimit në seancë përgatitore, datë 6.2.2015, procesverbalet e seancave përgatitore, procesverbalet e seancave gjyqësore, fletëthirrjet për të gjitha seancat, shpalljet për efekt njoftimi dhe vendimin objekt gjykimi, vendimin e ILD-së nr. ***, datë 20.4.2023.

32.8 Trupi gjykues lidhur me këtë çështje, referuar nenit 133/3 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon bërjen e njoftimit edhe në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës, arsyeton se: “Nga aktet në dosje provohet se subjekti ka pasqyruar në njoftimin përkatës edhe bërjen e njoftimit palës në ambientet e gjykatës, por në harmoni edhe me nenet 78⁷⁰ dhe 128⁷¹ të Kodit të Procedurës Civile vlerëson se ai nuk duhet të mungonte në kujdesin e treguar për të kontrolluar procesin e njoftimit. Në këtë logjikë, trupi gjykues, duke konstatuar nga njëra anë faktin se kjo detyrë kryesisht sipas dispozitave ligjore në fjalë është e nëpunësit gjyqësor dhe, nga ana tjetër, duke vërejtur se nga aktet e dosjes rezultoi që shkaqet dhe arsyet e bërjes së njoftimit me shpallje kanë pasur vazhdimësi prej zgjidhjes së martesës (nuk kanë qenë të panjohura për denoncuesin), ku pala ankuese ka rezultuar në mungesë dhe nuk ka ankuar vendimmarrjen, nuk ka shprehur interes për detyrim të pensionit ushqimor ndër vite, ka reaguar në një moment të caktuar, edhe pse njoftimi me shpallje është bërë edhe në ambiente të gjykatës, edhe në adresën e biznesit të tij, e cila presupozohet se mund të jetë edhe më e aksesueshme, çmon se në çështjen objekt vlerësimi nuk ka elemente të tilla, që të kualifikohen si mangësi thelbësore në ngarkim të subjektit.

33. Denoncim⁷² i shtetasës V.Ç

33.1 Denoncuesja në ankimin e saj nuk prezanton asnjë të dhënë apo shkelje në adresë të subjektit të rivlerësimit. Në ankesën e saj, denoncuesja ka bashkëngjitur vendimin nr. ***, datë 6.2.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt “Lirim e dorëzim sendi”, si dhe detyrimin për shpërblim dëmi të shkaktuar në keqbesim. Pretendimet e denoncueses duket se lidhen me themelin e çështjes, pasi padia e vënë në lëvizje prej saj është rrëzuar. Denoncuesja nuk jep të dhëna mbi ushtrimin e të drejtës ankimore dhe as nuk ka depozituar ndonjë dokumentacion për të kuptuar mbi statusin e çështjes.

33.2 Komisioni, në bazë të dokumentacionit të administruar, duket se nuk vëren ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

34. Denoncim⁷³ i shtetasit D.LL

34.1 Denoncuesi pretendon për vendimmarrje të padrejtë nga subjekte të tjera rivlerësimi, si dhe nga subjekti i rivlerësimit Adriatik Bocaj në disa procese gjyqësore të shqyrtuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë me objekt pronësie, për shkak të konfliktit të krijuar mes tij si përfitues i tokës me ligjin nr. 7501/1991 dhe palës tjetër si pronare, e njohur me vendim të KKKPronave ish-pronarëve. Denoncuesi në ankesën e tij pretendon se nuk është thirrur nga gjykata si palë në gjykim, se nuk ka marrë njoftim nga gjykata për asnjë seancë të zhvilluar dhe se vendimet janë marrë në mungesë të tij. Denoncuesi pretendon se i njëjti gjyqtar ka zhvilluar disa gjykime për të njëjtën çështje me të njëjtën palë paditëse. Denoncuesi ka depozituar kopje të vendimeve gjyqësore nr. ***, datë 20.6.2005 (gjykim themeli), nr. ***, datë 16.2.2006 (vendim me objekt

⁷⁰ “Nëpunësi gjyqësor merr pjesë në seancë gjyqësore dhe merr masa për zbatimin e urdhrave, ndjek procedurën e njoftimit të akteve dhe kryen detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor”.

⁷¹ “Gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues të çështjes kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga nëpunësit e administratës gjyqësore të caktuar për realizimin e tij”.

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷³ Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

“Sqarim dhe interpretim vendimi”), marrë nga subjekti i rivlerësimit, nr. ***, datë 12.10.2006, po me të njëjtin objekt “Sqarim, interpretim vendimi” dhe nr. ***, datë 25.3.2010, me objekt “Ndrejje të gabimeve”.

34.2 Nga verifikimi i vendimeve rezulton se denoncuesi ka qenë palë e paditur në procesin gjyqësor të zhvilluar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2005, por në vendimmarrje, në pjesën hyrëse të vendimit, tek përshkrimi i palëve ndërgjyqëse, nuk është pasqyruar mungesa e tij në shpalljen e vendimit, për rrjedhojë vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Duke iu referuar vendimeve dhe dispozitës mbi të cilën ka vendosur subjekti (neni 314 i Kodit të Procedurës Civile), thuhet se gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur është i errët dhe e kërkojnë palët. Kërkesa për interpretim mund të paraqitet në çdo kohë gjersa vendimi nuk është ekzekutuar. Në këto raste mund të bëhet ankim i veçantë. Duke iu referuar vendimit të fundit me objekt “Ndrejje të gabimeve”, në arsyetimin e tij konstatohet se kërkesa është vënë në lëvizje nga pala paditëse për shkak të pamundësisë së ekzekutimit të vendimit nga ZVRPP-ja Lezhë, pasi nuk kanë qenë të përcaktuara saktë me distanca kufij të sipërfaqeve të tokës, që u janë hequr të paditurve (një prej të cilëve është edhe denoncuesi). Po në këtë vendim duket se është marrë ekspert për të sqaruar dhe konkluduar lidhur me objektin e kërimit të paditësit.

34.3 Nga pikëpamja procedurale, në analizë të strukturës së vendimit, elementeve përbërëse të tij, duket se mungesa e pasqyrimin të prezencës ose jo të palës e bën të vështirë njoftimin e vendimit dhe, për pasojë, nuk arrihet të konstatohet lidhur me marrjen dijeni dhe ushtrimin e të drejtës ankimore. Rezultoi se vendimet e tjera gjyqësore (vendime themeli) që ka depozituar denoncuesi janë gjykuar nga të tjera subjekte rivlerësimi dhe me të tjera objekte gjykimi, si p. sh. shfuqizim i urdhrin të ZVRPP-së, përfshirë edhe pasojat e tjera në dokumentet e pronësisë, si në kartelën e pasurisë për shkak të fshirjeve të kërkuara në regjistrat e ZVRPP-së, krahasimisht nga objekti i padisë së gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, kundërshtim i vendimit të KKKPronave etj. dhe ku denoncuesi ka qenë në cilësinë e të paditurit. Në këtë kontekst, pretendimi i denoncuesit se subjekti ka gjykuar të njëjtat padi me të njëjtën palë paditëse duket se nuk qëndron.

34.4 Nga trajtimi i denoncimit vërehet se denoncuesi nuk ka pasqyruar asnjë të dhënë mbi të drejtën e ushtrimin të ankimit për vendimin gjyqësor të vitit 2005.

34.5 Komisioni për këtë çështje i ka kërkuar shpjegime subjektit, pasi ka konstatuar se: (i) vendimet nr. ***, datë 16.2.2006, nr. ***, datë 12.10.2006 dhe nr. ***, datë 25.3.2010, me objekt “Sqarim, interpretim vendimi” dhe “Ndrejje të gabimeve”, janë marrë në kundërshtim me nenin 314 të Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk i janë njoftuar edhe palës së paditur dhe, për pasojë, i ka mohuar edhe të drejtën e ushtrimin të ankimit të veçantë, për sa kohë kjo dispozitë e njej; (ii) në vendimin nr. ***, datë 25.3.2010, me objekt “Ndrejje të gabimeve”, kishte gjykuar si në çështje themeli duke thirrur ekspert dhe administruar më tej edhe aktin e ekspertimit. Dukej se në këtë rast ishte vepruar në kundërshtim me nenin 72/4 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile.

34.6 Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti ka parashtruar gjithë procedurën e ndjekur dhe vendimin e marrë në lidhje me pretendimin e shtetasit D.D (L1), informacion sipas tij, i bazuar në aktet e dosjes gjyqësore:

34.6.1 Në vitin 2005 është gjykuar çështja pronësore me palë ndërgjyqëse paditës A.D, të paditur B.D, D.D, P.D e KKKPronave Qarku Lezhë, si dhe persona të tretë ZVRPP Lezhë e Komisioni i ndarjes së Tokës fshati M, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të KKKPronave Lezhë”. Me vendimin nr. ***, datë 20.6.2005, gjykata ka pranuar padinë. Në seancën e datës 20.6.2005, të paditurit B.D, D.D, P.D nuk kanë qenë prezent. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 27.7.2005.

34.6.2 Paditësi A.D, duke parë se vendimi i mësipërm ishte i paqartë dhe kishte gabime, i është drejtuar gjykatës me kërkesë për ndrejjen e gabimeve dhe saktësimin e vendimit për t’u shprehur në lidhje me kërkesën e tij, dhe gjykata me vendimin nr. ***, datë 16.2 2006, nr. 21, datë 12.10.2006 dhe nr. ***, datë 25.3.2010, ka vendosur ta pranojë këtë kërkesë.

34.6.3 Në vendimin nr.***, datë 25.3.2010, me objekt “Ndrejje të gabimeve”, eksperti është thirrur për të sqaruar grafikisht kufizimet e pjesëve që duheshin hequr, meqenëse ndrejja e gabimit kishte si objekt saktësimin e pjesëve që duhet të hiqeshin në hartë.

34.6.4 Vendimi është marrë në mungesë të palës së paditur, shtetasi D.D, dhe vendimet gjyqësore njoftohen nga sekretaria gjyqësore. Ky vendim është ankimuar nga shtetasi D.D dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 17.9.2018, e ka prishur vendimin nr. ***, datë 25.3.2010, dhe e ka kthyer për rigjykim. Kundër vendimit të Apelit nr. ***, datë 17.9.2018, ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë shtetasi A.D dhe kjo çështje është në gjykim në Gjykatën e Lartë.

34.6.5 Meqenëse shtetasi D.D ka qenë në mungesë në marrjen e vendimit nr. ***, datë 25.3.2010, ai ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me kërkesë sipas dosjes civile nr. ***, datë 12.7.2016, rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit për vendimin nr. ***, datë 25.3.2010 dhe gjykata, me vendimin nr. ***, datë 22.12.2016, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës”.

34.6.6 Vendimi nr. ***, datë 22.12.2016, është ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër nga shtetasi D.D, e cila me vendimin nr. ***, datë 21.2.2018, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 22.12.2016 dhe rivendosjen në afat të kërkuarit për të ankimuar vendimin nr. ***, datë 25.3.2010”. Kundër vendimit nr.***, datë 21.2.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër, shtetasi A.D ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila e ka atë në gjykim. Subjekti ka depozituar kopje të plotë të dosjeve me nr. *** datë 14.12.2009, me nr. *** - datë 12.7.2016, nr. *** - datë 6.2.2006)

34.7 Trupi gjykues konstaton se në vendimmarrjet e subjektit nuk është treguar e drejta e ankimit të veçantë sipas dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Civile. Trupi gjykues, duke konstatuar se kjo mangësi në raport me gjithë çështjen e analizuar mbetet e vetme dhe se i përket periudhës jashtë vlerësimit profesional të subjektit, çmon se ajo nuk është e mjaftueshme për të prodhuar ndonjë penalizim për subjektin e rivlerësimit.

35. Denoncues⁷⁴ shtetasi G.T

35.1 Denoncuesi (me cilësinë e përfaqësuesit ligjor dhe Sekretarit të Përgjithshëm të OSPN-së P) pretendon për zvarritje në gjykim, paafësi dhe gjykim jo të drejtë për shumë subjekte rivlerësimi, si dhe për subjektin e rivlerësimit, Adriatik Bocaj. Denoncuesi ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit lidhur me çështjen civile nr. ***, datë 24.4.2017, me palë ndërgjyqëse/paditës OSPN P dhe të paditur z. V.F (me cilësinë e **** të Organizatës Sindikale të Pavarur të Punonjësve të Naftës Patos), person i tretë/Zyra e Vulave pranë Ministrisë së Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me objekt gjykimi “Deklarim i vlefshmërisë dhe pavlefshmërisë për dy çështje” (për mbledhjet e Kongresit V të organizatës, mbajtur në datën 27.9.2008 dhe 11.12.2009), sigurim padie me qëllim pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të Shkallës së Parë nr. ***, datë 23.10.2015, i cili është ankimuar. Denoncuesi ankohet se për subjektin e rivlerësimit është kërkuar përjashtimi dy herë dhe në të dyja rastet është vendosur rrëzimi i saj nga të tjera subjekte rivlerësimi. Denoncuesi nuk ka depozituar ndonjë dokumentacion provues mbi pretendimet e tij.

35.2 Komisioni administroi kopje të dosjes gjyqësore⁷⁵, që i përket vendimit nr. ***, datë 18.7.2019.

- Hyrje e çështjes

35.3 Nga aktet e dosjes rezultoi se çështja civile është regjistruar në datën 24.4.2017 dhe ka përfunduar në datën 18.7.2019. Me vendimin e formës së prerë nr. ***, datë 23.10.2015, të po kësaj gjykate (me një tjetër subjekt rivlerësimi), me kërkuar shtetasin F, është vendosur depozitimi i aktit të dalë nga Kongresi V i Sindikatës së Pavarur të Punonjësve të Naftës në regjistrin e organizatave sindikale të akteve. Në datën 24.10.2017, paditësi/denoncuesi ka depozituar parashtrime për sigurim padie. Sipas përgjigjes nr. *** prot., datë 20.11.2017, dhënë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë z. F, konfirmohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në përfundim të të cilit është konkluduar se shtetasi T. ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Me vendimin nr. ***, datë 30.6.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i pandehuri V.F është deklaruar fajtor për veprën penale “shpërdorim i detyrës” dhe burgimin e tij 1 vit e 10 muaj. Me vendimin nr. ***, datë 28.4.2017, të Gjykatës së Apelit

⁷⁴ Nr. *** prot., datë 19.4.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Tiranë, është lënë në fuqi vendimi nr. ***, datë 13.7.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kishte vendosur rrëzimin e padisë së OSPN-së, përfaqësuar nga z. T/denoncuesi, nën objektin e gjykimit “Depozitim i ndryshimeve dhe akteve të dala nga Kongresi V i OSPN-së në regjistrin e organizatave sindikale në zyrën e regjistrimit pranë kësaj Gjykate”. Në arsyetimin e vendimit pasqyrohet fakti se më parë po kjo gjykatë, me vendimin nr. ***, datë 29.4.2009, kishte vendosur rrëzimin e kërkesës së OSPN-së, përfaqësuar nga denoncuesi, duke refuzuar depozitimin e akteve dhe vendimeve të Kongresit V të jashtëzakonshëm të OSPN-së.

35.4 Mbi verifikimin e procedurës gjyqësore për çështjen e gjykuar nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se:

i. Në datën 28.4.2017, gjykata/subjekti i rivlerësimit ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në datën 11.9.2017.

ii. Në datën 9.5.2017, subjekti i rivlerësimit me vendimin datë 9.5.2017 ka caktuar seancën përgatitore më 15.5.2017. Rezulton se në këtë datë është përpiluar edhe fletëthirrja për seancën e datës 15.5.2017.

iii. Në datën 15.5.2017 është mbajtur procesverbal mbi zhvillimin e seancës përgatitore, seancë e cila nuk ka vijuar për shkak të mospasjes së mjetit të identifikimit nga pala e paditur, z. F. Kjo seancë është shtyrë për në datën 2.6.2017. Në këtë seancë, palët kanë qenë prezent me përjashtim të Zyrës së Vulave si person i tretë, që ka pasur dijeni për këtë seancë, por ka lindur nevoja e rinjoftimit. Rezulton se në datën 16.5.2017 është përpiluar edhe fletëthirrja për seancën e datës 2.6.2017.

iv. Është mbajtur procesverbal për seancën e datës 2.6.2017, në të cilën ka rezultuar se nga noterja në aktin e përfaqësimit të palës paditëse ka pasur një gabim dhe, për këtë shkak, nuk është legjitimuar kjo palë. Në këtë seancë, të gjitha palët kanë pasur dijeni, por është paraqitur vetëm paditësi me përfaqësim dhe i padituri. Kjo seancë është shtyrë për në datën 21.6.2017 për t’u rregulluar e meta në prokurë.

v. Rezulton se në datën 2.6.2017 është përpiluar edhe fletëthirrja për seancën e datës 21.6.2017.

vi. Është mbajtur procesverbal në datën 21.6.2017, në të cilën nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës paditëse, i cili ka bërë kërkesë për shtyrje seance. Seanca është shtyrë për në datën 7.7.2017 për t’u njoftuar paditësi dhe Zyra e Vulave. Rezulton se në datën 21.6.2017 është përpiluar edhe fletëthirrja për seancën e datës 7.7.2017.

vii. Me procesverbalin datë 7.7.2017 rezulton se është zhvilluar seanca dhe njëkohësisht është diskutuar edhe mbi kërkesën e paditësit për të pezulluar gjykimin, për të cilën gjithashtu palët kanë dhënë objeksionet e tyre. Ky procesverbal është i paplotë në dosjen e administruar.

viii. Me procesverbalin datë 11.9.2017 rezulton se është shtyrë seanca për datën 3.10.2017 për mosparaqitje të personit të tretë, Zyrës së Vulave, për shkak se nuk është kthyer ftesa. Rezulton se në datën 11.9.2017 është përpiluar edhe fletëthirrja drejtuar Zyrës së Vulave dhe DPPShtetit për seancën e datës 3.10.2017.

ix. Me shënimin e sekretares datë 3.10.2017 rezulton se është shtyrë seanca për në datën 24.10.2017, për shkak të një rasti vdekjeje të gjyqtarit/subjektit të rivlerësimit. Rezulton se në datën 3.10.2017 është përpiluar edhe fletëthirrja drejtuar Zyrës së Vulave dhe DPPShtetit për seancën e datës 24.10.2017.

x. Me procesverbalin datë 24.10.2017 rezulton se është zhvilluar gjykimi në mungesë të personit të tretë, Zyrës së Vulave. Në këtë seancë është kërkuar nga pala paditëse sigurimi i padisë dhe njëkohësisht rezulton se gjykata është shprehur lidhur me këtë kërkim, duke vendosur rrëzimin e saj dhe njëkohësisht është shprehur edhe lidhur me ankimin, i cili në këtë rast ushtrohet së bashku me vendimin përfundimtar.

xi. Në këtë seancë i është lënë kohë personit të tretë, DPPShtetit, për të përmbushur detyrën e lënë dhe, për këtë shkak, është shtyrë seanca në datën 22.11.2017. Në këtë procesverbal është konfirmuar gjithashtu edhe mbi kohën e gjatë të lënies së seancës për shkak se subjekti ka qenë me urdhrat e mbrojtjes.

xii. Në datën 15.11.2017, DPPShtetit ka dërguar për gjykatën dokumentacionin e kërkuar, që i përket pajisjes me vulë të ligjshme të Sindikatës së Pavarur të Punonjësve të Naftës në Shqipëri.

xiii. Me procesverbalin datë 22.11.2017 rezulton se është zhvilluar gjykimi, janë debatuar provat dhe është shtyrë seanca për në datën 15.12.2017 për shkak të lënies së detyrës nga gjykata personit të tretë dhe njëkohësisht pala paditëse ka kërkuar të sjellë dosjen nga Prokuroria e Rrethit Fier.

xiv. Me procesverbalin datë 15.12.2017 rezulton se është zhvilluar gjykimi, është kërkuar nga pala paditëse të njihet me provat që janë administruar nga palët në këtë seancë, është kërkuar gjithashtu që pyetjeve të shtruar me shkrim nga pala paditëse palës së paditur, t'i jepet kohë kësaj të fundit për të dhënë përgjigjet. Seanca është shtyrë për në datën 30.1.2018. Rezulton se në datën 22.1.2018 është përpiluar edhe fletëthirrja për seancën e datës 30.1.2018.

xv. Me procesverbalin datë 30.1.2018 rezulton se nuk është zhvilluar gjykimi pasi pala e paditur së bashku me fletëthirrjen ka depozituar edhe një kërkesë për shtyrje të procesit. Kjo seancë është vlerësuar që të shtyhet për shkak se ishte vendosur më parë që të sillte me shkrim, përgjigjet e pyetjeve të palës paditëse.

xvi. Me procesverbalin datë 20.2.2018 rezulton se nuk është zhvilluar gjykimi, pasi pritej të shprehej gjykata në varësi të vendimit, pra nëse do të vijonte të ishte subjekti gjyqtar i kësaj çështjeje.

xvii. Me kërkesën e datës 19.3.2018, z. T/paditësi është ankuar për zvarritje të procesit gjyqësor dhe njëkohësisht ka parashtruar se ka bërë dy kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit/subjektit të rivlerësimit, një kërkesë në datën 11.9.2017 dhe një tjetër kërkesë në datën 30.1.2018.

xviii. Me shënimin e sekretares dhe gjyqtarit/subjektit të rivlerësimit, datë 15.3.2018, është shtyrë seanca për datën 14.10.2018, ku thuhet *“pasi dita e sotme është ditë pushimi”*.

xix. Me shënimin e sekretares dhe gjyqtarit/subjektit të rivlerësimit *“nuk ka datë”*, shtyhet seanca për në datën 13.4.2018, pasi nuk është shprehur gjyqtari tjetër për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit.

xx. Me procesverbalin datë 13.4.2018 rezulton se është shtyrë seanca për datën 4.5.2018, duke bërë njoftimin për të paditurin nëpërmjet shpalljes sipas nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile, edhe pse pala paditëse është shprehur se ka pasur dijeni i padituri. Në njoftimin me shpallje për të paditurin V.F, thuhet se është vepruar në këtë mënyrë për shkak se në fletëthirrjen e nisur për njoftim është bërë shënim *“i larguar”*.

xxi. Me procesverbalin datë 4.5.2018 rezulton se i është dhënë fund hetimit gjyqësor dhe janë ftuar palët në konkluzionet përfundimtare në një afat 5 ditë deri në datën 9.5.2018. Në gjendjen që janë aktet nuk pasqyrohet procesverbal i datës 9.5.2018.

xxii. Në datën 7.5.2018, OSPN-ja ka kërkuar me materialin e protokolluar⁷⁶ me nr. ***, datë 7.5.2018: (i) pezullimin e gjykimit të çështjes civile nr. *** akti, datë regjistrimi 24.4.2017, me kryesues subjektin e rivlerësimit, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes penale nr. *** akti, që zhvillohej në Gjykatën e Apelit Vlorë; (ii) riçeljen e hetimit gjyqësor për të paraqitur: (a) vendimin penal të Gjykatës së Apelit Vlorë, në ngarkim të të paditurit F; (b) për të tërhequr dosjet që u përkasin vendimeve civile nr. ***, datë 13.7.2015, nr. ***, datë 23.10.2015 dhe nr. ***, datë 17.4.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

xxiii. Rezulton se në datën 1.6.2018 është përpiluar edhe fletëthirrja drejtuar të gjitha palëve ndërgjyqëse për seancën e datës 14.6.2018. Z. T në këtë fletëthirrje ka konfirmuar se në datat 14, 18 dhe 26 qershor 2018 ndodhet në procese të tjera gjyqësore në Vlorë. Rezulton se në datën 14.6.2018 është përpiluar edhe fletëthirrja drejtuar të gjitha palëve ndërgjyqëse për seancën e datës 19.6.2018. Z. T në këtë fletëthirrje ka konfirmuar se ka marrë dijeni me telefon.

xxiv. Me procesverbalin datë 19.6.2018 dhe 25.6.2018 janë shtyrë seancat gjyqësore për shkak se kanë munguar palët ndërgjyqëse, respektivisht në datën 19.6.2018 kanë munguar pala paditëse dhe ajo e paditur, ndërkohë ka qenë prezent vetëm personi i tretë, i cili ka kërkuar pushimin e çështjes. Por, duke qenë se çështja ka qenë në konkluzionet përfundimtare, është shtyrë për në datën 25.6.2018 dhe në datën 25 kanë munguar të gjitha palët ndërgjyqëse e sërish çështja është shtyrë me të njëjtin shkak për në datën 29.6.2018 (detyrë njoftim për palën paditëse me fletëthirrje dhe telefon, pala e paditur ka vijuar në mungesë dhe

⁷⁶ Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

njoftim për personin e tretë). Rezulton se në datën 25.6.2018 është përpiluar edhe fletëthirrja drejtuar të gjitha palëve ndërgjyqëse për seancën e datës 29.6.2018. Për z. T në këtë fletëthirrje ka shënim se *“mbyll cel kur i telefonojnë dhe se i është dërguar SMS”*. Me procesverbalin për njoftimin e OSPN-së me telefon, datë 26.6.2018, për zhvillimin e seancës në datën 29.6.2018, konfirmohet njoftimi përkatës me SMS pasi ka fikur telefonin.

xxv. Me procesverbalin datë 29.6.2018 konfirmohet kërkesa e palës paditëse se ka kërkuar pezullimin e gjykimit dhe riçeljen e hetimit gjyqësor. Po në këtë procesverbal konfirmohet vendimmarrja e subjektit mbi këto kërkitime, për të cilat ka vendosur rrëzimin e tyre. Më pas, po në këtë procesverbal është kërkuar edhe përjashtimi i subjektit nga gjykimi i çështjes. I është lënë tri ditë afat palës paditëse të paraqesë kërkesën për përjashtim gjyqtari.

xxvi. Në datën 12.7.2018, një tjetër subjekt rivlerësimi i po së njëjtës gjykatë ka njoftuar subjektin e rivlerësimit mbi depozitimin e kërkesës datë 4.7.2018 të OSPN-së për përjashtimin e gjyqtarit/subjektit të rivlerësimit. Rezulton se në datën 13.7.2018 është përpiluar edhe fletëthirrja drejtuar të gjitha palëve ndërgjyqëse për seancën e datës 18.7.2018.

xxvii. Me procesverbalin datë 18.7.2018 konfirmohet se nuk janë paraqitur palët ndërgjyqëse dhe se është vendosur pushimi i çështjes civile me nr. *** akti. Në procesverbal janë treguar shpenzimet gjyqësore, afati i ankimit dhe e drejta e ankimit. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.7.2018.

xxviii. Në tërësi, deri në zhvillimin e seancës datë 19.3.2018, në gjendjen që ndodhen aktet, janë zhvilluar gjithsej 15 seanca. Përgjithësisht shtyrja e seancave rezulton e justifikuar. Rezulton se subjekti është shprehur me procesverbalin datë 29.6.2018 lidhur me kërkesa të palëve për sigurim padie, pezullim çështjeje dhe riçelje të hetimit.

xxix. Po deri në seancën e datës 19.3.2018 duket se nuk provohet pretendimi i denoncuesit se ka pasur zvarritje të procesit gjyqësor, pasi përgjithësisht edhe vetë pala paditëse/denoncuesi ka parashtruar disa kërkesa paraprake, ku për dy prej tyre, për përjashtim gjyqtari, është dashur kohë për të pritur e shtyrë seanca dhe, po ashtu, edhe vetë pala paditëse disa herë duket se është bërë shkak për shtyrje të seancave (për shkaqe objektive apo njohje me dokumente). Duket se procesi ka përfunduar në pushim gjykimi edhe për shkak të mungesës së vetë palës paditëse.

35.5 Komisioni për këtë çështje në gjendjen që ndodheshin aktet deri në fazën e hetimit i ka kërkuar shpjegime subjektit, pasi dukej se nuk konfirmoheshin veprime procedurale të subjektit në seancën e datës 7.7.2017 (pasi procesverbali është i paplotë dhe në këtë seancë thuhet se është kërkuar pezullimi i çështjes nga pala paditëse); dukej i paqartë shënimi i sekretares gjyqësore në datën 15.3.2018, pasi është shtyrë seanca pas shtatë muajve për në datën 14.10.2018, ndërkohë që nga gjykata është mbajtur procesverbal në datën 13.4.2018. Duket se nuk rezultojnë njoftime për palët për seancën e datës 13.4.2018, edhe pse shënimi tregon se palët duhet të njoftohen; nuk rezultonte i administruar njoftimi për palën e paditur V.F për seancën e datës 13.4.2018 me shënimin “i larguar”, pas së cilës është proceduar me njoftimin me shpallje; nuk pasqyrohej procesverbal i datës 9.5.2018; nuk rezultonin të dhëna lidhur me statusin e çështjes, pra nëse palët kanë ankimuar vendimin dhe çfarë është vendosur më tej.

35.6 Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjekti, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, ka shpjeguar procedurën e ndjekur dhe vendimin e marrë në lidhje me pretendimin e shtetasit G.T, duke parashtruar se:

35.6.1 *Procesverbali i seancës gjyqësore, datë 7.7.2017, është i plotë dhe i përbërë nga dy fletë, është mbajtur audio dhe seanca ka nisur në orën 11:36:25, dhe pala paditëse, pala e paditur dhe pala e tretë, DP e Policisë së Shtetit, kanë qenë prezent, kurse personi i tretë - Zyra e Vulave, ka qenë në mungesë. Në këtë seancë, pala paditëse ka kërkuar pezullimin e çështjes, por gjykata nuk e ka pranuar këtë kërkesë të palës, duke e kaluar çështjen në seancë gjyqësore, ashtu siç pasqyrohet në procesverbalin bashkëlidhur këtij prapësimi (procesverbalin e seancës).*

35.6.2 *Seanca e datës 14.3.2018 nuk është zhvilluar pasi ka qenë ditë pushimi. Për këtë është bërë shënimi në datën 15.3.2018 (një ditë pas pushimit), kur është caktuar seanca e radhës, ku sekretaria ka bërë një lapsus duke shkruar datën 14.10.2018, kur në fakt sipas fletëthirrjeve dhe shënimit të gjyqtarit në kapak të*

dosjes është data 13.4.2018, por edhe në proceset e regjistruara në sistem, rubrika “Shënimet e shtyrjes së seancave” janë të qarta, si dhe ku palët kanë marrë njoftim për këtë datë, siç konstatohet nga 4 fletëthirrjet e palëve në proces, si dhe shënimet e seancave në sistemin audio të nxjerrë nga IT-ja e gjykatës, të cilat jua vendosim në dispozicion.

35.6.3 *Në procesverbalin e datës 13.4.2018 në seancë është konstatuar se i padituri V.M, sipas fletëthirrjes së datës 3.4.2018, ndodhej jashtë shtetit dhe për këtë është administruar fletëthirrja nr. ***, datë 3.4.2018, nga e cila rezulton se është larguar dhe ndodhet jashtë shtetit. Me vendim gjykata vendosi të njoftojë me shpallje të paditurin V.M. Për këtë subjekti ka depozituar fletëthirrjen dhe procesverbalin e seancës.*

35.6.4 *Seanca e datës 9.5.2018 nuk është zhvilluar, sepse pala paditëse ka bërë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit dhe për këtë sekretaria ka bërë një shënim për moszhvillimin e seancës dhe njoftimin e palëve, shënim i cili ndodhet në dosje.*

35.6.5 *Për sa i përket statusit të çështjes, në të tri seancat e fundit gjykata me vendimin nr. ***, datë 18.7.2018, ka pushuar çështjen bazuar në nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile, me shkakun e mosparaqitjes së përfaqësuesit të paditësit, shtetasit G.T. Palët nuk e kanë ankimuar vendimin dhe vendimi ka marrë formë të prerë dhe ndodhet në arkivin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

35.6.6 *Për këtë çështje ankuesi është ankuar edhe në ILD për zvarritje të procesit. ILD, me vendimin nr. ***, datë 24.2.2023, ka arsyetuar se: “Dhënia e vendimit nr. ***, datë 18.7.2018, është brenda kriterëve procedurale të afatit të arsyeshëm, se nuk ka zvarritje të gjykimit dhe, si rrjedhojë, nuk ka shkelje disiplinore lidhur me këtë pretendim” dhe ka vendosur arkivimin e saj.*

35.7 *Subjekti ka depozituar kopje të plotë të dosjes gjyqësore, vendimin e ILD-së nr. ***, datë 24.2.2023, shënimet e seancave në sistem, të lëshuar nga IT-ja e gjykatës.*

35.8 *Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, ka konstatuar se subjekti ka provuar me dokumentacion kërkesat e Komisionit. Pretendimi i subjektit se caktimi i datës së seancës 14.10.2018 është lapsus i sekretarisë gjyqësore, është i pranueshëm, pasi identifikohet si i tillë nga analizimi i akteve në dosje dhe konkretisht fletëthirrjeve, shënimit të gjyqtarit në kapak të dosjes datë 13.4.2018, por edhe në proceset e regjistruara në sistem dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues, në bazë të dokumentacionit të administruar, nuk konstaton ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë mangësi në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.*

36. Denoncim⁷⁷ i shtetas A.SH

36.1 *Denoncuesja ankohet për vendimmarrje jo të drejtë të dhënë ndaj saj nga subjekti i rivlerësimit në shqyrtimin dhe vlerësimin e çështjes nr. ***, datë 14.12.2017, me objekt “Ndërprerje të marrëdhënies së punës”. Denoncuesja ankohet për vonesë në shpalljen/publikimin e vendimit, si dhe për parregullsi të gjyqtarit në shkrimin e vendimit, duke ngatërruar gjeneralitetet e saj në vendimmarrje, si dhe ato të institucionit ku ajo kishte punuar. Denoncuesja ka depozituar vendimin nr. ***, datë 14.12.2017, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ku ajo është në cilësinë e palës paditëse, me palë të paditur qendra “****” Tiranë, vendim me të cilin është vendosur rrëzimi i padisë.*

36.2 *Subjekti ka shpjeguar⁷⁸ lidhur me pretendimin e denoncueses për tejkalim të afatit të shpalljes së vendimit gjyqësor, duke sqaruar se në seancën e datës 11.12.2017 pala e paditur ka paraqitur konkluzionet përfundimtare dhe, pasi i është dhënë fund shqyrtimit gjyqësor, ka vendosur që vendimi të shpallej i arsyetuar në datën 14.12.2017 për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe ngarkesës në punë. Subjekti ka sqaruar se shpallja është vendosur të shtyhet për 3 ditë, konform dhe parashikimeve të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile. Subjekti ka depozituar procesverbalet e seancave gjyqësore të zhvilluara, si dhe kopje të plotë të akteve të administruara gjatë gjykimit të kësaj çështjeje.*

⁷⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 4.5.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁸ Me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, datë 7.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

36.3 Nga verifikimi i vendimit konstatohet se në pjesën arsyetuese, në rrethanat e faktit dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, në pikën 2, gjeneralitetet e paditëses janë treguar ndryshe, nga A.SH në A.B. Po ashtu, edhe në vendimin e lëshimit të urdhrat të ekzekutimit nr. ***, datë 14.12.2017, në pjesën arsyetuese pasqyrohen të dhëna të gabuara, sikurse pretendon denoncuesja. Sërish identiteti pasqyrohet A.B dhe pala e paditur tregohet AMF, ndërkohë që nga paditësja/denoncuese është paditur si institucion punëdhënës qendra “****”, Tiranë. Por, nga verifikimi i pjesës hyrëse dhe dispozitivit të secilit vendim të subjektit, rezultojnë të dhëna të sakta të gjeneraliteteve të palëve ndërgjyqëse.

36.4 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me faktin konstatues se dukej se në vendimmarrjet përkatëse pasqyrohen gabime materiale të kufizuara vetëm në pjesën arsyetuese, si dhe të jepte të dhëna lidhur me statusin e çështjes.

36.5 Lidhur me këtë çështje, subjekti ka pranuar faktin e konstatimit të gabimeve materiale në arsyetim të vendimit nr. ***, datë 14.11.2017, dhe këto gabime kanë ndodhur për shkak të punimit mbi një material tjetër, por edhe si pasojë e ngarkesës së madhe në arsyetimin e vendimeve. Pala paditëse nuk ka kërkuar ndreqjen e gabimeve në shkrim sipas ligjit procedural, por e ka ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Për sa i përket statusit të çështjes, pala paditëse e ka ankimuar vendimin nr. ***, datë 14.11.2017, në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe kjo e fundit nuk është shprehur ende, e ka çështjen në gjykim. Subjekti ka depozituar kopje të dosjes civile me nr. ***, datë 4.9.2017.

36.6 Trupi gjykues, duke konstatuar faktin se kemi të bëjmë me gabime materiale, që nuk kanë passjellë pasoja për palët, përkundër asaj që rezultoi në pjesën hyrëse dhe dispozitivin e secilit vendim të subjektit, rezultojnë të dhëna të sakta të gjeneraliteteve të palëve ndërgjyqëse për këtë çështje, nuk vëren problematika që cenojnë kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

37. Denoncim⁷⁹ i shtetasit M.P

37.1 Denoncuesi (me cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k.) pretendon për gjykim joprofesional dhe të korruptuar nga subjekti i rivlerësimit në dhënien e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 21.3.2013, me palë paditëse shtetasin K.I, palë të paditur shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt gjykimi “Përmbushje të detyrimeve kontraktuale nga kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 14.11.2009”. Denoncuesi ankohet se për shkak të vendimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit ka pësuar dëmtim financiar dhe material të biznesit të tij. Denoncuesi ka depozituar bashkëlidhur me denoncimin e tij, vendimin gjyqësor nr. ***, datë 21.3.2013, me objekt “Përmbushje e detyrimit kontraktor të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 14.11.2009, si dhe detyrimin për të paguar penaltetet kontraktore 1% si dëmshpërblim”, dhënë në Gjykatën e Shkallës së Parë Lezhë nga subjekti i rivlerësimit ... vijon. Vendimi rezultoi të jetë ankimuar dhe Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e saj nr. ***, datë 20.4.2015, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

37.2 Komisioni, në analizë të pretendimeve të denoncuesit, konstaton se ato i përkasin themelit të çështjes dhe, për pasojë, trajtimi i denoncimit nuk është në kompetencë të Komisionit.

38. Denoncim⁸⁰ i shtetasit E.K

38.1 Denoncuesi ankohet për gjykim dhe vendimmarrje jo të drejtë nga subjekti i rivlerësimit. Në procesin e gjyqësor për çështjen me objekt “Zgjidhje martesë”, nr. ***, datë 19.12.2018, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka vendosur në favor të shtetasit E.K në cilësinë e ish-bashkëshortes, duke i lënë asaj në përdorim pasurinë e paluajtshme, e cila sipas pretendimit të tij është blerë me kredi bankare pesë vite përpara martesë. Denoncuesi ankohet edhe për caktimin e masës së pensionit ushqimor ndaj fëmijës në raport me të ardhurat e tij.

Denoncuesi ka depozituar vendimin gjyqësor të subjektit të rivlerësimit nr. ***, datë 19.12.2018, nga verifikimi i të cilit Komisioni konstatoi se në objektin e padisë është edhe kërkesa për përdorimin e banesës. Denoncuesi ka sqaruar se ka paraqitur ankim të pjesshëm pranë Gjykatës së Apelit në datën 10.1.2019, me

⁷⁹ Nr. *** prot., datë 19.11.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁰ Nr. *** prot., datë 18.1.2019 administruar në dosjen e Komisionit.

objekt “Ushtrimin e përbashkët të përgjegjësisë dhe kohës së qëndrimit të njëjtë ndaj dy fëmijëve pa ndryshuar banesë”.

38.2 Nga shqyrtimi dhe analizimi i vendimit Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncueses kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit, pra me themelin e çështjes, vlerësime të cilat nuk janë objekt vlerësimi nga ky Komision.

39. Denoncim⁸¹ i shtetas E.N

39.1 Denoncuesja (si përfaqësuese e vajzës së saj/paditëse I.N) ankohet për zvarritje në gjykim dhe vendim të gabuar të njëanshëm dhe favorizues për palën e paditur, dhënë nga disa subjekte ku përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit.

Nga parashtrimet e denoncueses konfirmohet se ajo me cilësinë e ndërhyrësit kryesor ka ushtruar të drejtën ankimore në Apel. Denoncuesja bashkëlidhur me denoncimin ka depozituar një vërtetim, datë 15.8.2018, lëshuar nga sekretaria e Gjykatës Tiranë, nga verifikimi i të cilit nuk identifikohet zhvillimi i procesit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit.

39.2 Për sa më sipër, në nivelin që janë provat, ku nuk mund të konstatohej nëse subjekti i rivlerësimit kishte gjykuar çështje me këtë palë ndërgjyqëse, dhe në raport me pretendimet e denoncueses ndaj subjektit të rivlerësimit, Komisioni i kërkoi subjektit⁸²: i) të shpjegonte dhe qartësonte çdo vendimmarrje të tij dhënë në adresë të denoncueses (nëse kishte pasur të tilla), duke u përqendruar kryesisht në pretendimin e saj, për zvarritje të gjykimit; ii) të sqaronte statusin e vendimmarrjeve; iii) të depozitonte çdo dokumentacion për të provuar shpjegimet.

39.3 Subjekti në shpjegimet e tij ka parashtruar se ka zhvilluar një proces gjyqësor mbi padinë e ngritur nga paditësja I.N, e përfaqësuar nga denoncuesja, me të paditur shoqërinë “***”, me objekt gjykimi “Mosrespektim kontrate”. Subjekti ka sqaruar se ka zhvilluar një numër të konsiderueshëm seancash, që në të shumtën e rasteve janë shtyrë për shkak të kërkesave të palës paditëse për t’u përfaqësuar me avokat, për të ndryshuar bazën ligjore të kërkesës në padi, për t’u gjykuar kërkesa e paditëses për përjashtim gjyqtari/të subjektit të rivlerësimit dhe në përfundim të zhvillimit të seancave nuk është paraqitur paditësja, shkak i cili ka çuar gjykatën në pushimin e gjykimit të çështjes sipas neneve 126, 179 e vijues të Kodit të Procedurave Civile. Subjekti ka theksuar se vetë paditësja, por edhe përfaqësuesja e saj/denoncuesja, kanë pasur dijeni për datën dhe orën e gjykimit dhe se pa shkak të arsyeshëm nuk janë paraqitur.

39.4 Subjekti ka renditur të gjitha seancat e zhvilluara në këtë proces gjyqësor, duke cilësuar edhe shkakun dhe arsyen e shtyrjes së secilës prej tyre.

39.5 Subjekti ka depozituar procesverbalet e seancave gjyqësore dhe vendimin nr. ***, datë 1.7.2016, për pushimin e gjykimit, si dhe kopje të plotë të të gjitha akteve të administruara gjatë gjykimit të kësaj çështjeje.

39.6 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar vërehet se janë zhvilluar 16 seanca, sikurse edhe subjekti kishte renditur secilën prej tyre me shkakun përkatës të shtyrjes. Gjithashtu, vërehet se secila seancë është shtyrë për shkaqe të arsyeshme në përputhje me Kodin e Procedurës Civile. Procesverbalet tregojnë prezencën e palëve, kërkimet e tyre, arsyet e shtyrjes, datën e seancës së ardhshme dhe përmbushjen e detyrimeve për të njoftuar. Seancat janë shtyrë disa herë për shkak të kërkesave të vetë palës paditëse, për të caktuar avokat, për mosprezencë në seancën e radhës ku do të paraqiteshin ekspertët e caktuar, edhe pse ka pasur dijeni nga seanca e kaluar, për të pritur mbi depozitimimin e kërkesës për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga kjo çështje, etj. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se pala paditëse/denoncuesja ka ankimuar vendimin e pushimit.

39.7 Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr. ***, datë 6.12.2016, mbi ankimin e paditëses/denoncueses ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin se për këtë çështje janë zhvilluar shumë seanca, janë administruar një sërë provash, janë thirrur ekspertë, të cilëve i janë lënë detyra dhe, në këto kushte, paditëses duhej t’i jepej mundësia të dëgjohej në

⁸¹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸² Me pyetësin nr. 4, datë 7.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

seancë. Gjykata në vendimin e saj shprehet se me qëllim që ajo/ankuesja të realizonte interesin e saj të ligjshëm, duhet t'i ishte caktuar një datë tjetër gjykimi. Gjithashtu, gjykata në vendim ka arsyetuar se paditësja ka provuar nga aktet në dosje se ka qenë e sëmurë dhe se është paraqitur me disa minuta vonesë për seancën ku është vendosur pushimi i çështjes.

39.8. Nga verifikimi i akteve të administruara vërehet se në dosje është administruar një kërkesë e paditësës/denoncueses, datë 1.7.2016 (datë që është pushuar çështja objekt gjykimi), ku i kërkohet gjyqtarit të çështjes/subjektit të rivlerësimit që të vijojë me procesin, pasi është paraqitur me vonesë se është e sëmurë.

39.9 Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me pretendimet e denoncueses për vendimmarrjen e tij në raport me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 6.12.2016.

39.10 Subjekti edhe për këtë rast ka parashtruar procedurën e ndjekur dhe vendimin e marrë në lidhje me pretendimin e shtetasës E.N, informacion i bazuar në aktet e dosjes gjyqësore. Sipas subjektit, pretendimi i denoncueses nuk qëndron, sepse, sipas akteve të administruara që ndodhen në dosjen e gjykimit në shkallë të parë nuk ka të administruar ndonjë kërkesë të kërkuases, që mban datën 1.7.2016. Nga verifikimi i akteve të administruara në dosjen e gjykimit në Gjykatën e Apelit, gjendet një kërkesë e kërkuases që mban datën 1.7.2016 dhe në këtë kërkesë protokollin i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë shënimin u depozitua në datën 1.7.2016, ora 13:10. kur seanca gjyqësore ka qenë në orën 09.30, pra kërkesa është paraqitur në protokollin e Gjykatës, mbasi gjyqtari e ka pushuar çështjen. Por edhe nga sqarimet që bën kërkuasesja në këtë kërkesë, duket qartë që ajo e ka bërë kërkesën mbasi gjyqtari e ka pushuar çështjen sepse thotë: *“arsyeja e vonesës sime sot në gjyq për vetëm 5 minuta është problemi që kam me shëndetin”* dhe me pas kërkon që të vazhdojë gjyqi. Te gjitha seancat janë zhvilluar me audio dhe video dhe janë në arkivin elektronik të gjykatës. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj nr. ***, datë 6.12.2016 mbi ankimin e paditësës/denoncueses ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin se për këtë çështje janë zhvilluar shumë seanca, janë administruar një sërë provash, janë thirrur ekspertë të cilëve i janë lënë detyra dhe në këto kushte paditësës duhej ti jepej mundësia të dëgjohej në seancë. Gjykata në vendimin e saj shprehet se me qëllim që ajo/ankuesja të realizonte interesin e saj të ligjshëm, duhet t'i ishte caktuar një datë tjetër gjykimi. Gjithashtu, gjykata në vendim ka arsyetuar se paditësja ka provuar nga aktet në dosje se ka qenë e sëmurë dhe se është paraqitur me disa minuta vonesë për seancën ku është vendosur pushimi i çështjes.

39.11 Subjekti ka parashtruar se pavarësisht vendimit të Gjykatës së Apelit, vendimmarrja e tij është e drejtë dhe e marrë sipas ligjit (neni 179 i Kodit të Procedurës Civile pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve në proces), ndërsa vendimmarrja nga Gjykata e Apelit është bërë në bazë të provave që janë paraqitur nga ankuesi, prova të cilat nuk janë paraqitur në Shkallë të Parë. Subjekti ka depozituar kopje të seancave gjyqësore, kërkesën e paraqitur në protokoll nga ankuesja në datën 1.7.2016, ora 13:10, e firmosur nga protokollin, e shoqëruar kjo me disa fletë analizash të ankueses, dorëzuar në Gjykatën e Apelit.

39.12 Trupi gjykues, në analizë të të dhënave të dala nga aktet në dosje në raport me shpjegimin e subjektit, vlerëson se qëndron pretendimi i tij se ai ka marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, sipas nenit 179/1 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo çmuarje është rrjedhojë e konstatimit të verifikimit të kërkesës së palës për zhvillimin e gjykimit, ku pasqyrohet ora e depozitimit të saj pas orës së zhvillimit të seancës gjyqësore, pra e depozitar pas marrjes së vendimit të pushimit të çështjes. Rezulton se Gjykata e Apelit ka vendosur mbi një fakt të ri, pra pas kërkesës për zhvillim të gjykimit, ku ankuesja gjithashtu ka provuar kërkesën edhe me analiza mjekësore për të treguar arsyen e vonesës. Prishja e këtij vendimi vjen për shkaqe dhe arsye të ndodhura dhe të provuara pas marrjes së vendimit të pushimit të çështjes dhe, për pasojë, nuk mund të bëjnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, i cili gjithashtu ka pushuar çështjen bazuar në kërkesat e parashikuara në ligj. Në përfundim për këtë çështje, trupi gjykues nuk evidenton mangësi që cenojnë kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit.

40. Denoncim⁸³ i shtetasit A.N

⁸³ Shkresë nr. *** prot., datë 17.4.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

40.1 Denoncuesi në cilësinë e familjarit të palës ndërgjyqësore të së paditurës ankohet për shkelje flagrante të ligjit gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit, në vendimin gjyqësor të çështjes civile nr. ***, datë 25.3.2019, me palë paditës N.M, e paditur V.M, me objekt “Zgjidhje martese”. Denoncuesi pretendon se vendimi gjyqësor nr. ***, datë 25.3.2019, është zhvilluar në mungesë të palës së paditur, pa marrë dijeni dhe e papërfaqësuar me mbrojtës, e pasqyruar në vendimin e gjykatës, në kundërshtim me nenin 134 dhe 135 të Kodit të Familjes, për njoftimin e palëve në proces gjykimi; nuk është vlerësuar drejt që fëmija t’i lihej nënës dhe jo babait; nuk është vlerësuar drejt masa e pensionit ushqimor në vlerën 5000 lekë, duke mos mbajtur në konsideratë të ardhurat e nënës, e cila është e papunë.

40.2 Denoncuesi ka depozituar vendimin gjyqësor të sipërcituar.

40.3 Nga verifikimi i vendimit dhe nga informacioni i dhënë nga denoncuesi nuk konstatohen të dhëna mbi ushtrimin e të drejtës ankimore.

40.4 Nga verifikimi i vendimit gjyqësor, nga pikëpamja procedurale, rezulton se çështja është regjistruar në datën 2.11.2018 dhe ka përfunduar në datën 25.3.2019. Në dispozitivin e vendimit janë treguar se kujt i përkasin shpenzimet gjyqësore, si dhe është treguar e drejta e ushtrimit të ankimit.

40.5 Komisioni administroi⁸⁴ dosjen gjyqësore që i përket këtij vendimi gjyqësor.

i. Në dosje është administruar raporti i vlerësimit psikologjik, datë 25.3.2019, i kryer me metoda bashkëkohore, me intervistime në ambiente zyre e familjare. Raporti ka rekomanduar qëndrimin e fëmijës së mitur në shtëpinë ku ai ishte lindur e jetonte, në Itali.

ii. Në datën 8.11.2018, subjekti ka vendosur të caktojë seancën gjyqësore në datën 18.2.2019, ndërkohë urdhri për këtë vendimmarrje konfirmon se pala paditëse ka marrë dijeni në seancë pajtimi, sot, datë 1.2.2019.

iii. Gjyqtari në datën 9.11.2018 ka vendosur të kryejë veprimet paraprake, nga ku padia ka rezultuar pa të meta, sipas neneve 154/a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile.

iv. Me procesverbalin datë 4.12.2018 është vlerësuar padia pa të meta, është kërkuar lëshimi i deklaratës së mbrojtjes nga e paditura jo më vonë se 10 ditë nga komunikimi i padisë, si dhe informimi i së paditurës lidhur me asistencën që mund të kërkojë e paditura për të plotësuar deklaratën e mbrojtjes apo lidhur me pasojat që vijnë nga moslëshimi i saj. Për këtë seancë rezulton se i është dërguar fletëthirrje të paditurës në adresën e përcaktuar në padi nga paditësi me vendqëndrim në Shqipëri.

v. Me procesverbalin datë 24.12.2018 rezulton se janë kryer veprimet përgatitore dhe seanca është shtyrë për të njoftuar të paditurën me telefon pasi nuk ishte paraqitur, për të cilën paditësi ka vendosur në dispozicion edhe numrin përkatës të telefonit. Për këtë seancë konfirmohen fletëthirrje për palët ndërgjyqëse në adresa të konfirmuara në padi me vendqëndrim në Shqipëri/Pukë.

vi. Me procesverbalin datë 1.2.2019 rezulton se ka vijuar kryerja e veprimeve përgatitore. Procesverbali konfirmon se e paditura ka pasur dijeni për datën dhe orën e gjykimit. Në këtë procesverbal konfirmohet edhe zhvillimi i seancës së pajtimit në mungesë dhe gjithashtu edhe konfirmimi i paditësit se e paditura ka braktisur banesën bashkëshortore. Për këtë seancë gjyqësore konfirmohet fletëthirrje për të paditurën në numër celulari Itali, numër i pasqyruar në fletëthirrje ku shënohet “dërgon SMS, por pa u treguar ndonjë nënshkrim ftuesi/nëpunësi gjykate”.

vii. Me procesverbalin e seancës gjyqësore datë 18.2.2019, rezulton se seanca gjyqësore është zhvilluar në mungesë të palës së paditur për të cilën gjykata ka pasqyruar faktin se nga aktet është deklaruar mungesa e saj në datë 1.2.2019. Po në këtë seancë me kërkesë të palës paditëse është vendosur edhe marrja e psikologes për të hartuar raportin e vlerësimit dhe prej saj është bërë edhe betimi. Seanca e radhës datë 4.3.2019 nuk është zhvilluar për shkaqe objektive të palës paditëse. Nga aktet rezultoi se në datë 4.3.2019 është kërkuar

⁸⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, administruar në dosjen e Komisionit.

nga përfaqësuesi me prokurë (datë 28.11.2018) i palës paditëse shtyrje seance për shkak të një procesi gjyqësor që ka përkuar në të njëjtën orë.

viii. Me procesverbalin datë 25.3.2019 është administruar raporti i vlerësimit të psikologes, është dëgjuar pala paditëse (përfaqësuesi), ka përfunduar hetimi, janë administruar provat dhe është shpallur vendimi. Raporti i vlerësimit ka cilësuar se të dy palët jetojnë në Itali.

40.6 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, pasi në gjendjen që ndodheshin aktet, dukej se nuk provohej marrja dijani e palës së paditur, ndërsa gjykimi është zhvilluar në mungesë të saj, duke u konfirmuar në procesverbalin datë 1.2.2019 se e paditura ka pasur dijani për datën dhe orën e gjykimit e gjithashtu nuk konfirmohej statusi aktual i vendimmarrjes.

40.7 Në qëndrimin e tij, subjekti ka parashtruar procedurën e ndjekur dhe vendimin e marrë në lidhje me pretendimin e shtetasit A.N, informacion i bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, duke u shprehur se: *“Nga verifikimi i dosjes familjare me nr. ***, datë 2.11.2018, rezulton se dosja më ka ardhur për gjykim në datën 7.11.2018 dhe, mbasi kam verifikuar aktet me vendimin e datës 9.11.2018, e kam kaluar në veprime paraprake, në datën 4.12.2018, ora 09:30”.*

40.7.1 Në seancën e veprimeve paraprake të datës 4.12.2018 nuk u paraqitën as paditësja dhe as i padituri, ndonëse për paditësin ka marrë dijani avokati dhe për të paditurën ka marrë dijani motra e saj (sipas shënimit në fletëthirrje). Në këto kushte, gjykata vendosi të kalojë seancën e pajtimit në datën 24.12.2018, ora 11:00, duke i dhënë mundësi të paditurës për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes.

40.7.2 Në seancën e pajtimit të datës 24.12.2018 u paraqit paditësi, të cilit iu morën gjeneralitetet dhe e paditura nuk u paraqit, sepse nuk kishte dijani (sipas fletëthirrjes rezultoi se ka firmosur i vjehri). Në këto kushte, gjykata nuk e ka marrë të mirëqenë marrjen dijani të së paditurës. Gjithashtu, në këtë seancë, paditësi kërkoi që e paditura të njoftohet me anë të telefonit, sepse ndodhet jashtë shtetit. Gjukata, ndodhur në këto kushte dhe bazuar në nenin 135 të Kodit të Familjes, vendosi ta shtyjë seancën e pajtimit për datën 1.2.2019, ora 10:00, duke urdhëruar njoftimin e së paditurës me telefon.

40.7.3 Në seancën e pajtimit të datës 1.2.2019 u paraqit paditësi dhe e paditura nuk u paraqit, por sipas fletëthirrjes e paditura është njoftuar nëpërmjet telefonit nga zyra e njoftimeve të gjykatës, duke i dërguar SMS, duke mbajtur edhe një procesverbal njoftimi, i datës 21.1.2019, në të cilin thuhet se iu dërgua SMS bashkëlidhur komunikimi - *procesverbali i mbajtur nga ftuesi për këtë njoftim*. Në këtë seancë, gjykata e mori të mirëqenë njoftimin dhe e ka zhvilluar gjykimin në mungesë të së paditurës. Gjukata, pasi kreu seancën e pajtimit, vendosi të kalojë çështjen në seancë gjyqësore, në datën 18.2.2019.

40.7.4 Në seancën gjyqësore të datës 18.2.2019 u paraqit paditësi, u paraqit përfaqësuesi me prokurë, ndërsa e paditura me vendim të ndërmjetëm është deklaruar në mungesë në seancën e mëparshme, për rrjedhojë gjykimi vijon në mungesë të saj. Gjukata vazhdoi gjykimin në mungesë të së paditurës. Në këtë seancë, gjykata vendosi të caktojë edhe një ekspert psikolog. Gjukata, pasi kreu seancën, vendosi ta shtyjë në datën 4.3.2019, ora 12:30, për t'i dhënë mundësi ekspertit psikolog të kryejë raportin e vlerësimit të palëve.

40.7.5 Seanca gjyqësore e datës 4.3.2019 nuk u zhvillua, sepse përfaqësuesi me prokurë kishte bërë një kërkesë për shtyrje meqë ndodhej në një gjyq penal dhe e paditura, me vendim të ndërmjetëm, është deklaruar në mungesë në seancën e mëparshme, për rrjedhojë gjykimi vijonte në mungesë të saj. Gjukata vendosi të shtyjë seancën gjyqësore në datën 25.3.2019, ora 12:30. Në seancën gjyqësore të datës 25.3.2019 u paraqit paditësi, u paraqit përfaqësuesi me prokurë dhe e paditura me vendim të ndërmjetëm është deklaruar në mungesë në seancën e mëparshme, për rrjedhojë gjykimi vijonte në mungesë të saj. Në këtë seancë, gjykata vendosi të pranojë raportin e ekspertit psikolog (i cili ka qenë edhe në shtëpi të së paditurës, por ajo nuk e bëri të mundur takimin me të) dhe, pasi dëgjoji pretendimet përfundimtare të paditësit, mori vendim. Midis të tjerash, gjykata vendosi edhe një detyrim ushqimor që e paditura duhej të paguajë për fëmijën e mitur në masën 5000 lekë në muaj, duke qenë se ajo është pa punë sipas analizës së gjykatës dhe duke u bazuar në Kodin e Familjes.

40.7.6 Në vijim, subjekti ka parashtruar se kjo çështje nuk është ankimuar në gjykatat më të larta dhe vendimi ka marrë formë të prerë, duke depozituar kopje të së gjithë dosjes⁸⁵ me nr. ***, datë 2.11.2018.

40.8 Trupi gjykues, në analizë të të dhënave të dala nga aktet në dosje, konstaton vërtetësinë e tyre, sikurse ka shpjeguar subjekti në prapësime. Ky fakt gjithashtu përforcohet nga fakti se vendimi është ligjësuar nga gjykata më e lartë. Lidhur me marrjen dijeni të palës së paditur në këtë çështje familjare me objekt “Zgjidhje martesë”, nga aktet në dosje provohet me procesverbal të ftuesit se është njoftuar e paditura me SMS dhe, në këto kushte, gjykimi është zhvilluar në mungesë. Sipas të dhënave të dala parashtruar më sipër, trupi gjykues konstaton se konfirmohet njoftimi i palës me një nga mënyrat e parashikuara në ligj, referuar konkretisht nenit 129⁸⁶ të Kodit të Procedurës Civile, duke mos konstatuar kështu mangësi profesionale nga subjekti lidhur me këtë çështje.

41. Denoncim⁸⁷ i shtetasit A.D

41.1 Denoncuesi ankohet për gjykim jo të drejtë dhënë nga subjekti i rivlerësimit për vendimin gjyqësor nr. ***, datë 8.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Pjesëtim pasurie”, por nuk paraqet fakte apo rrethana që mund të lidhen me pretendimet e tij ndaj subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi pretendon se banesa me sipërfaqe 51.78 m², objekt i pjesëtimit të pasurisë i takon atij dhe vajzave të tij dhe jo ish-bashkëshortes, e cila nga vendimi gjyqësor nr. ***, datë 8.3.2019, ka fituar banesën dhe detyrimin për të paguar ½ e vlerës së pronës.

41.2 Nga shqyrtimi i këtij denoncimi, Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncueses kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit, pra me themelin e çështjes, vlerësime të cilat nuk janë në kompetencë të Komisionit.

42. Denoncim⁸⁸ i shtetasës E.M

42.1 Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit me anë të veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe pa marrë parasysh asnjë provë apo deklaratë të dhënë, në vendimin e datës 26.8.2020 ka cenuar dhe vënë në rrezik jetën e saj dhe të fëmijëve. Denoncuesja sqaron në ankesën e saj se për shkak të dhunës fizike dhe verbale ndaj saj dhe fëmijëve është në proces divorci me bashkëshortin e saj, shtetasin A.M, ish-gjyqtar. Ajo ka sqaruar se për shkak të dhunës së vazhdueshme ndaj saj dhe fëmijëve janë pajisur me urdhër mbrojtjeje nga Gjykata e Tiranës, pas kërkesëpadive të ngritura datë 22.8.2020 nga denoncuesja dhe datë 23.8.2020 nga fëmijët. Denoncuesja pretendon se vetëm 4 ditë më pas bashkëshorti A.M, duke shfrytëzuar miqësinë me subjektin e rivlerësimit, ngre padi kundër saj, në kundërshtim me ligjin, ku kërkon të jetojë në të njëjtën banesë me ta, edhe pse prej 6 muajsh jetonte diku tjetër, ka përfutur nga subjekti i rivlerësimit urdhër mbrojtjeje me të padrejtë, me vendim të datës 26.8.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vënë kështu në rrezik jetën e saj dhe dy fëmijëve.

42.2 Për sa më sipër, duket se denoncuesja pretendon për vendimmarrje të padrejtë në referim të provave të depozituara, të cilat i përkasin debatit gjyqësor në seancë dhe përkojnë me themelin e çështjes. Në të tilla kushte vërehet se denoncimi nuk përmban fakte e rrethana, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

43. Denoncim⁸⁹ i shtetasës E.M

43.1 Denoncuesja ankohet lidhur me veprime të kryera në dëm të saj nga disa subjekte rivlerësimi, përfshirë dhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesja prezanton në këtë denoncim kryesisht problematika dhe

⁸⁵ Gjithsej 104 fletë.

⁸⁶ *Thirrja në gjykatë (ndryshuar me ligjin nr. 122/2013) – “Thirrja në gjykatë bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjes, e cila duhet të përmbajë gjykatën që e ka nxjerrë, emrin, mbiemrin e personit të thirrur, kohën dhe vendin e seancës gjyqësore, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, si dhe pasojat ligjore, në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë. Gjykata, kur e çmon të dobishme dhe kur pala ka dhënë pëlqimin paraprak, urdhëron që thirrja në gjykatë të bëhet nëpërmjet njoftimit me mjete të komunikimit elektronik, sipas rregullave të përcaktuara në këtë kre”.*

⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 29.5.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 31.8.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

shqetësime të ardhura në mënyrë të njëpasnjëshme nga ish-bashkëshorti i saj, ndaj saj dhe fëmijëve gjithashtu. Ajo në mënyrë kronologjike rendit urdhrat e mbrojtjes të dhënë në favor të saj dhe fëmijëve. Denoncuesja pretendon për procese gjyqësore të nisura ndaj tij, që sipas saj nuk do të jenë objektive për shkak të detyrës së ushtruar prej tij në sistemin e drejtësisë dhe njohjes që ka me kolegët dhe që lehtësisht mund ta favorizojnë. Denoncuesja në këtë denoncim përmend disa emra subjektsh rivlerësimi, hedh edhe dyshime për ta, por nuk prezanton fakte apo rrethana konkrete për subjektin e rivlerësimit, për të cilin Komisioni do të mund të shqyrtonte me objektivitet denoncimin.

44. Denoncim⁹⁰ i shtetasit A.M

44.1 Denoncuesi ankohet për shkelje të rënda ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes civile familjare me nr. regj. themeltar ***, datë regjistrimi 7.12.2020. Në ankesën e tij, denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit me veprimet e tij i ka sjellë dëm pasuror denoncuesit, duke mos marrë parasysh kërkesën e ngritur prej tij/si palë paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë, në zbatim të neneve 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, por e ka rrëzuar atë, duke pretenduar mosdorëzim të provave të mjaftueshme nga pala paditëse. Denoncuesi pretendon për mosshqyrtim të çështjes brenda afateve të parashikuara nga ligji, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesëpadisë. Denoncuesi pretendon për shtrembërim të fakteve në vendimin gjyqësor, duke parashtruar argumente që nuk i përgjigjen realitetit dhe nuk përputhen me provat e paraqitura bashkëlidhur kërkesëpadisë.

44.2 Denoncuesi ka kallëzuar penalisht subjektin e rivlerësimit për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Denoncuesi ka depozituar urdhrin e përfaqësuesit të organit të akuzës, datë 18.2.2021, për regjistrimin e procedimit penal mbi materialet e kallëzimit nr. *** (pa emër).

44.3 Nga verifikimi i urdhrat rezultojnë thujtë të njëjtat pretendime të kallëzuesit si në procesin civil me objekt pjesëtim pasurie.

44.4 Denoncuesi ka depozituar vendimin për shpallje moskompetence, datë 22.2.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me të cilën është vendosur shpallja e moskompetencës për hetimin e procedimit penal nr. ***, dhe dërgimi i akteve të këtij procedimi pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si Prokuroria më e afërt në këtë rast, për shkak se denoncuesi më parë ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe njëkohësisht edhe subjekti i rivlerësimit/i kallëzuar është gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

44.5 Në bazë të dokumentacionit të administruar, Komisioni konstatoi dhe i kërkoi⁹¹ subjektit të shpjegojë dhe dokumentojë lidhur me pretendimet e denoncuesit se: i) nuk kishte shqyrtuar kërkesën për masë provizore/sigurim padie të parashikuar nga ligji, brenda 5 ditëve nga paraqitja e saj, sikurse e parashikon neni 202 i Kodit të Procedurës Civile; ii) ishte tejkalluar afati maksimal 30-ditor i lënë palës së paditur, për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes.

44.6 Subjekti, në përgjigjen e dhënë lidhur me mosshqyrtimin e çështjes për masën provizore të parashikuar nga ligji, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesëpadisë, sikurse e parashikon neni 202 i Kodit të Procedurës Civile, ka sqaruar se në datën 10.12.2020 është caktuar si gjyqtar për shqyrtimin e kërkesëpadisë me objekt “Pjesëtim pasurie bashkëshortore”, me palë paditëse A.M dhe të paditur E.M, ku ka konstatuar se në pikën e fundit të padisë paditësi ka kërkuar sigurimin e padisë. Në referim të neneve 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur që kjo çështje duhet të gjykohet në dhomë këshillimi, si dhe ka caktuar seancën në datën 15.12.2020, brenda afatit të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile, ka gjykuar në dhomë këshillimi dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova, duke treguar edhe lejimin e ankimit të veçantë në Gjykatën e Apelit.

44.7 Ndërsa për pretendimin tjetër të denoncuesit lidhur me tejkallimin e afatit maksimal 30-ditor të lënë palës së paditur për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes, subjekti sërish ka prezantuar veprimet procedurale të ndjekura prej datës 16.12.2020, kur ka marrë në shqyrtim në veprime paraprake padinë dhe aktet bashkëlidhur, ku pasi ka vlerësuar se padia ka qenë pa të meta në bazë të neneve 154/a dhe 156 të Kodit të

⁹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 25.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹¹ Me pyetësin nr. 4, datë 7.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

Procedurës Civile, i ka kërkuar të paditurit që brenda afatit 30-ditor nga njoftimi i saj dhe akteve bashkëlidhur të paraqesë deklaratën e mbrojtjes. Subjekti ka renditur njoftimet e bëra palës së paditur, më konkretisht ka konfirmuar se sikurse provohet dhe nga dëftesa e komunikimit e lëshuar në datën 16.12.2020 e paditura E.M (G) është njoftuar dhe ka marrë dijëni në datën 18.12.2020. E paditura ka dorëzuar në sekretarinë gjyqësore deklaratën e mbrojtjes dhe provat bashkëlidhur në datën 14.1.2021, pra brenda afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 158/2 i Kodit të Procedurës Civile. “*Pra, në rastin konkret, - ka shpjeguar subjekti, - zbatohen parashikimet e nenit 158 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat i kam respektuar me rigorozitet*”. Subjekti gjithashtu ka sqaruar se gjatë zhvillimit të gjykimit, meqenëse pala paditëse ka paraqitur një kallëzim penal ndaj tij dhe meqenëse ka çmuar se drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe duhet të duket, ka paraqitur kërkesën për dorëheqje, kërkesë e cila është pranuar nga zv. kryetari i Gjykatës. Subjekti ka sqaruar se çështja është rishortuar dhe në bazë të shortit ishte caktuar një tjetër gjyqtare, V.Z, e cila për mosparaqitjen e palës paditëse ka vendosur pushimin e gjykimit. Subjekti ka depozituar kopje të akteve të administruara në dosjen civile, me palë paditëse, shtetasin A.M.

44.8 Komisioni nga aktet e administruara konstatoi se nuk provohet ky pretendim i denoncuesit. Krahasuar me datën që subjekti ka marrë kërkesën për shqyrtim, rezultoi se ai ka vendosur brenda afatit ligjor lidhur me sigurimin e padisë, ndërsa denoncuesi bën përllogaritjen nga regjistrimi i kërkesës në gjykatë dhe, po ashtu, edhe nga aktet e depozituara vërehet se deklarata e mbrojtjes nga e paditura është depozituar brenda afatit 30-ditor. Rezultoi se çështja është gjykuar nga një tjetër subjekt pas kërkesës së këtij të fundit për dorëheqje. Kërkesa për dorëheqje është bërë për shkak të kallëzimit penal që ka bërë denoncuesi për subjektin.

44.9 Nga dokumentacioni i administruar konfirmohet shpjegimi i dhënë nga subjekti, i cili rezultoi i bazuar në kërkesat e Kodit të Procedurës Civile në raport me dy pretendimet e denoncuesit.

44.10 Lidhur me këtë rast, Komisioni i ka kërkuar subjektit të konfirmonte/dokumentonte statusin e procedimit penal nr. ***, dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

44.11 Sipas kërkesës të Komisionit, subjekti ka shpjeguar se çështja është në hetim dhe për këtë ka depozituar dhe shkresën me nr. *** prot., datë 28.8.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

45. Denoncim⁹² i shtetasit R. D’A.

45.1 Denoncuesi në ankesën e tij sqaron se është në një proces gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ai sqaron se çështja e parë është pushuar nga subjekti i rivlerësimit dhe se ndaj tij është aplikuar një gjobë me vendim të masës paraprake. Në vijim konfirmon se ka nisur një tjetër proces gjyqësor me objekt “Marrjen e kujdestarisë ligjore për fëmijën e tij të mitur” dhe se në datën 28.7.2023 është zhvilluar seanca e parë gjyqësore për marrjen e masës së përkohshme deri në përfundim të procesit gjyqësor. Denoncuesi pretendon se në këtë rast është kryer një proces i parregullt gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit, për të cilin ka pasqyruar disa arsye.

45.2 Ai ka pretenduar se nga subjekti i rivlerësimit: (i) i është mohuar e drejta për t’u shprehur në seancë, por më tej me këmbënguljen e përfaqësueses së tij është përmbushur kjo e drejtë; (ii) është vendosur rrëzimi i kërkesës, si dhe caktimi i pensionit ushqimor për fëmijën e mitur në një masë të konsiderueshme (500 euro), pasi sipas tij fëmija është mjaft i vogël dhe nuk i nevojitet kjo shumë; (iii) është vendosur prej tij në dispozicion të gjykatës vërtetim i mjekes për të provuar anën shëndetësore të së ëmës së fëmijës dhe se gjyqtari/subjekti i rivlerësimit nuk ka urdhëruar këqyrjen e gjendjes shëndetësore të saj me ekspertët përkatës.

45.3 Denoncuesi ka depozituar vendimin nr. ***, datë 17.7.2023, nga ku vërehet se në këtë proces ai ka qenë në cilësinë e paditësit, me të paditur shtetasin V.R, me objekt “Ushtrimin e përgjegjësisë prindërore” dhe se që në fillim të seancës përgatitore përfaqësuesja e tij ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i padisë,

⁹² Shkresë nr. *** prot., datë 8.8.2023.

duke kërkuar pushimin e saj. Për këtë kërkesë ka shprehur dakordësinë edhe e paditura. Denoncuesi nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me pretendimet e tij të përshkruara më sipër.

45.4 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me pretendimet e denoncuesit, duke qartësuar edhe statusin aktual të çështjes.

45.5 Në parashtrimet e tij, subjekti ka shpjeguar se pretendimi i ankuesit se çështja e parë është pushuar nga subjekti i rivlerësimit dhe se ndaj tij është aplikuar një gjobë me vendim të masës paraprake nuk qëndron.

45.5.1 Në vijim, subjekti ka parashtruar procedurën e ndjekur dhe vendimin e marrë në lidhje me pretendimin e shtetasit R. D'A se sipas tij: *“Çështja objekt gjykimi më ka ardhur për gjykim në datën 14.4.2023 nga sekretaria e gjykatës e, duke qenë se kishte në objekt dhe marrjen e masës së përkohshme, gjykata vendosi të kalojë për gjykim masën e përkohshme në datën 20.4.2023, ora 08:00.*

Në seancë ka qenë prezent paditësi e, duke qenë se nuk e njihte gjuhën shqipe, është marrë një përkthyes i gjuhës italiane, z. K.K. Në këtë seancë është vendosur lënia e fëmijës në kujdestari, të drejtat e takimit dhe detyrimi ushqimor. Nuk është e vërtetë që gjykata ka aplikuar gjobë ndaj paditësit.

*Në datën 17.7.2023 është lënë seanca përgatitore, në të cilën paditësi nuk është paraqitur, por është paraqitur përfaqësuesja e tij me prokurë, avokatja, e cila kërkoi të heqë dorë nga gjykimi dhe pushimin e çështjes, kërkesë me të cilën ishte dakord dhe e paditura. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 17.7.2023, vendosi pushimin e gjykimit të çështjes.*

*Në datën 25.7.2023, ankuesi ka bërë përsëri kërkesë, e cila më ka ardhur nga sekretaria në datën 26.7.2023 për gjykim e çështjes me nr. ***, datë 20.7.2023, me palë paditëse R. D'A dhe e paditur V.R, me objekt “Ushtrimin e përgjegjësisë prindërore” dhe marrjen e masës së përkohshme, lënien e fëmijës në kujdestari të paditësit. Duke qenë se kishim të bënim me një masë të përkohshme, gjykata vendosi të zhvillojë seancën gjyqësore për masë të përkohshme në datën 28.7.2023, ora 08:30. Në këtë seancë ishte i pranishëm paditësi së bashku me avokaten dhe, duke qenë se ishte shtetas italian, ishte prezent dhe përkthyesja, znj. V.G”.*

45.5.2 Subjekti ka shpjeguar se pretendimi se i është mohuar e drejta për t'u shprehur në seancë nuk qëndron, sepse në seancë ka dhënë shpjegime avokati, por edhe vetë paditësi me ndihmën e përkthyeses. Pretendimi se është vendosur rrëzimi i kërkesës, si dhe caktimi i pensionit ushqimor për fëmijën e mitur në një masë të konsiderueshme (500 euro), pasi sipas tij fëmija është mjaft i vogël dhe nuk i nevojitet kjo shumë, por sipas gjykatës ky pretendim nuk qëndron, pasi fëmija që nga dita e lindjes dhe deri në seancën e dhënies së masës së përkohshme ka qëndruar nën kujdestarinë e nënës, e cila është kujdesur për mirëritjen dhe edukimin e saj, ndërsa për sa i përket pensionit ushqimor gjykata ka marrë parasysh deklarinimin e paditësit në seancë, ku ka pohuar se zhvillon aktivitetin e tij në Republikën e Shqipërisë, e provuar nga ekstrakti i QKB-së.

45.5.3 Sipas subjektit, pretendimi i palës paditëse se është vendosur prej paditësit në dispozicion të gjykatës vërtetim i mjekes për të provuar anën shëndetësore të së ëmës së fëmijës dhe se gjyqtari/subjekti i rivlerësimit nuk ka urdhëruar këqyrjen e gjendjes shëndetësore të saj me ekspertët përkatës, nuk mund të ngrihet në këtë moment procedural, pasi kjo është një masë e përkohshme dhe nuk kryhen veprime procedurale për thirrjen e ekspertit. Veprime të tilla kryhen kur çështja kalohet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore.

45.5.4 Subjekti ka bërë me dije se aktualisht çështja është në fazën paraprake. Subjekti ka depozituar edhe kopje të plotë të dosjes⁹³ me nr. ***, datë 19.4.2023, si dhe dosjen e re me nr. ***, datë 20.7.2023, me të njëjtat palë.

45.6 Trupi gjykues, në analizë të fakteve të dala nga aktet në dosje, ka konstatuar se çështja është ngritur në mënyrë të përsëritur nga denoncuesi, ku rasti i parë është pushuar me kërkesë të vetë përfaqësuesit të denoncuesit, dhe se rasti i dytë është ende në gjykim dhe për të Komisioni nuk ka kompetencë vlerësimi

⁹³ Gjithsej 172 fletë.

sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës. Mbi këto konstatime trupi gjykues çmon se nuk ka fakte e rrethana, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

46. Nisur nga sa më sipër, Komisioni, duke vlerësuar përmbajtjet e denoncimeve në fjalë në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe tipologjinë e ankesave të vendimmarrjeve të subjektit, çmon se mangësia e konstatuar në rastin e denoncuesit me iniciale D. Ll., në raport me gjithë hetimin për rastet e tjera, është e pamjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë/praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e tij, për të prodhuar penalizim të subjektit në kriterin profesional apo procesin në tërësi të rivlerësimit dhe, në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, çmon se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues sipas neneve 44/a dhe 59/c të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Adriatik Bocaj: a) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c) ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Adriatik Bocaj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 15.9.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES Lulzim HAMITAJ Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Etleda ÇIFTJA
Anëtare